

Raport për rezultatet e konsultimeve publike

1. Titulli i draft aktit

Projektligj “Për Shërbimin e Jashtëm në Republikën e Shqipërisë”

2. Kohëzgjatja e konsultimeve

Kohëzgjatja e konsultimit publik ishte 20 ditë pune, duke filluar nga data 2 deri më 30 gusht 2024.

3. Metoda e konsultimit

Metodat e konsultimit të përdorura për këtë projektligj janë si vijojnë:

1. Konsultime të Grupit të Punës ngritur më Urdhrin e Ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 48, datë 31.1.2024 “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e projekt-akteve mbi rregullimin e veprimtarisë së Shërbimit të Jashtëm të Republikës së Shqipërisë”;
2. Publikimi në Regjistrin Elektronik për Njoftimin dhe Konsultimin Publik;
3. Njoftimi nëpërmjet postës elektronike zyrtare personelit të shërbimit të jashtëm, për t’u konsultuar me projektligjin e shpallur për konsultim, për të dhënë kontribut.

4. Palët e interesit të përfshira

Palët e interesuara, që kanë dhënë komente/kontribut në konsultimet publike përmes RENJKP dhe postës elektronike zyrtare të Koordinatorit për Njoftimin dhe Konsultimin Publik janë:

1. Alban Kënuti
2. Faik Dishnica, MEPJ
3. Suela Janina, Ambasador, Misioni i Përhershëm i Republikës së Shqipërisë në OKB
4. Parid Vishko, MEPJ (Këshilltar për më shumë se 13 vjet dhe në ministri që prej vitit 1996)
5. Këshilli i Ambasadorëve Shqiptarë (Besnik Mustafaj, President)
6. Ejona Hoxha, MEPJ
7. Marsida Kurti, MEPJ
8. Genti Bendo, Ministër Fuqiplotë, MEPJ
9. Silvana Leskaj, MEPJ

Përbërja e Grupit të Punës për hartimin e projektaktit me Urdhrin e MEPJ nr. 48, datë 31.1.2024 është si vijon:

1. Zëvendësministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, përgjegjës për çështjet e integritetit evropian, Kryetar;
2. Ambasadori i Republikës së Shqipërisë pranë Misionit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian, anëtar;
3. Drejtori i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, anëtar;
4. Drejtori i Drejtorisë së Organizatave Ndërkombëtare, anëtar;
5. Drejtori i Drejtorisë për të Drejtën e Detit dhe Marrëdhëniet me Gjykatat Ndërkombëtare, anëtar;
6. Drejtori i Drejtorisë së të Drejtës Ndërkombëtare dhe Traktateve, anëtar;
7. Drejtori i Drejtorisë së Çështjeve Konsullore, anëtar;
8. Drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve të Përgjithshme, anëtar;
9. Drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, anëtar.

Në mbledhjet e Grupit të Punës janë ftuar përfaqësues të institucioneve si vijojnë:

1. Departamenti i Administratës Publike,
2. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar,
3. Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit,
4. Drejtoria e Përgjithshme e Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit, Ministria e Drejtësisë,
5. Ekspertë të jashtëm: Franci Terihati (jurist) dhe Dritan Shano (ekonomist).

5. Pasqyra e komenteve të pranuara me arsyetimin e komenteve të pranuara/refuzuara

Komentet/sugjerimet e ardhura nëpërmjet RENJKP-së dhe postës elektronike zyrtare të Koordinatorit për Njoftimin dhe Konsultimin Publik të bëra nga palët e interesuara, grupohen si vijon:

Çështja e adresuar (psh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)	Komenti (grumbulloni dhe përmbledhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)	Palët e interesuar a (renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)	Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)	Justifikimi
Mbi procesin e konsultimit	Duke qenë se ligji për shërbimin e jashtëm është baza ligjore rregullatore e trupës diplomatike dhe prek në mënyrë të drejtëpërdrejtë zhvillimin e karrierës së diplomatëve, të drejtat dhe detyrimet e tyre, konsultimi në një fazë të hershme me trupën diplomatike është nevojë që garanton zbatimin korrekt të ligjit. Përtej një detyrimi moral të konsultimit me trupën e prekur eventualisht nga ndryshimet e ligjit, procesi i konsultimit është një detyrim ligjor. Neni 5 i Kodit të Procedurave Administrative përcakton se parimi i transparencës kërkon që “Organet publike ushtrojnë veprimtarinë administrative në mënyrë transparente dhe në bashkëpunim të ngushtë me personat fizikë dhe juridikë të përfshirë në të”. Për të promovuar një vendimmarrje të hapur, transparente dhe demokratike, është e rëndësishme që projektaktet të konsultohen me grupet e interesit, subjektet e përfshira drejtpërdrejt apo indirekt në fushën e zbatimit të tyre, ekspertë apo profesionistë të fushës së rregullimit të projektaktit. Përpara se të hapet për konsultim të jashtëm, projektligji duhet të kalonte në proces të konsultimit të brendshëm. Gjithashtu Manuali për hartimin e legjislacionit, botim i Ministrisë së Drejtësisë, evidenton të gjitha hapat që duhet të ndiqen gjatë procesit të hartimit të një akti të ri ligjor, sipas të cilit “Konsultimi është një parakusht me rëndësi për transparencën e vendimmarrjes dhe prandaj standardet më të larta të transparencës duhet të zbatohen lidhur me të. Një konsultim i organizuar keq mund të jetë jo produktiv dhe mund të pengojë pranimin e	Suela J.	I refuzuar	Në përputhje me Kreun III piken 14 të VKM Nr.584, date 28.8.2003, projektakti është hartuar nën përgjegjësinë e strukturës juridike, grupit të punës në zbatim të Urdhrit nr. 48, datë 31.01.2024, grup i cili përbëhet nga strukturat përgjegjëse dhe ato të fushave përkatëse të Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme, në vijim të grumbullimit të mendimeve nga drejtues, specialist të drejtorive, sektorëve, misioneve diplomatike si dhe me struktura të shoqërisë civile me objektin, qellimin dhe zbatimin e projektaktit. Në përputhje me nenin 6 të ligjit Nr. 146/2014, organi publik ka detyrimin t’i krijojë mundësi për pjesëmarrjen e publikut dhe të gjitha palëve të interesuara në

	legjislacionit. Për këto arsye, konsultimi duhet të sigurojë trajtim të mjaftueshëm dhe të barabartë të të gjitha palëve pjesëmarrëse në procesin e konsultimit. Kur gjatë konsultimit të brendshëm lindin vështirësi ose mendime të ndryshme, këto duhet të zgjidhen me debat të drejtpërdrejtë. Në përfundim të konsultimit të brendshëm, ministria përgjegjëse duhet të rishikojë projektligjin në dritën e komenteve të marra dhe duhet të informojë palët e konsultuara lidhur me rezultatin e rishikimit.” Relacioni që shoqëron projekt-ligjin informon se “projekt ligji është hartuar nga një grup i posaçëm pune i ngritur në Ministrinë e për Evropën dhe Punët Jashtme, në përbërje të të cilit ka pasur përfaqësues edhe nga Ministria e Drejtësisë, Departamenti i Administratës Publike, Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish- Sigurimit të Shtetit, si dhe ekspertë të jashtëm”. Nga përbërja duket që grupi i punës ka karakter ndërinstitutional, i cili në një rast të tillë duhet të jetë ngritur dhe të funksionojë mbi bazën e një Urdhri të KM. Pyetje: A mundet që ky urdhër dhe përbërja e grupit t’i bëhet e njohur të gjithë anëtarësisë së shërbimit të jashtëm, më qëllim që të krijohet besimi në përfaqësimin e interesave të përgjithshme në procesin e hartimit të projektligjit?			procesin e njoftimit e të konsultimit publik. Projektakti ka përfunduar procesin e konsultimit publik dhe palët e interesuara kanë patur mundësinë të ushtrojnë të drejtat e njohura nga neni 9 i ligjit. Drafti është hartuar nga një grup pune në të cilin kanë bërë pjesë diplomatë, është shpërndarë për mendim dhe komente në fazën e hershme të tij brenda strukturës së ministrisë dhe në misionet diplomatike, të cilat gjithashtu përbëhen nga diplomatë dhe është konsoliduar bazuar në komentet dhe sugjerimet e kësaj “trupe diplomatësh”. Kërkesa për komente brenda strukturës është shpërndarë më 19 dhjetor 2023, komentet e diplomatëve të mbledhura gjatë muajit janar 2024 përbën draftin e parë të projektligjit të diskutuar që në mbledhjen e parë të grupit të punës më dt. 08.02.2024.
Mbi nevojën e hartimit të një ligji të ri	Nga relacioni që shoqëron ligjin mësojmë se “përgatitja e këtij projektligji erdhi si një domosdoshmëri për rregullimin e disa problematikave të hasura nga aplikimi i ligjit aktual për shërbimin e jashtëm”.	Suela J.	I refuzuar	Urdhër nr. 48, datë 31.01.2024 Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e projekt-akteve

	Çdo projekt për hartimin e një ligji duhet të paraprihet nga vlerësimi dhe vërtetimi i arsyeve pse ligji nevojitet, në veçanti justifikimi i tij politik dhe ligjor. Pyetjet kryesore që shtrohen në fillim të nje procesi të hartimit të legjislacionit janë: A është identifikuar qartë problemi që duhet të rregullohet? A është bërë vlerësim i nevojës për ndërhyrje legislative? Ndërkohë që nuk bëhet e qartë se cilat kanë qenë këto problematika që kanë nxitur ndryshimin e ligjit. Identifikimi i qartë i tyre është i domosdoshëm për të justifikuar sipas teknikës legislative nevojën e ndryshimit të ligjit dhe pamundësinë e rregullimit të këtyre problematikave me instrumenta të tjera alternative, sikurse mund të ishte ndryshimi i disa neneve të ligjit aktual. Nga krahasimi i ligjit aktual (2015) dhe këtij projekti, në vështrimin tim shikohet një ngjashmëri e plote në 93% të teksteve duke shtruar pyetjen nëse është e justifikuar paraqitja e një projekti të ri apo mund të arrihet qëllimi i kërkuar nëpërmjet amendimeve ligjore. Pyetje: A mundet që të ndahet analiza e parimeve të teknikës legislative të bërë nga grupi i punës për argumentimin e paraqitjes së një projekti të ri? Manuali i hartimit të legjislacionit përcakton se “Kur ndryshimet janë të tilla që nuk prekin thelbin e ligjit, por rregullojnë disa aspekte të tij, është më mirë që të bëhen ndryshime në ligjin ekzistues. Kur ndryshimet janë të shumta, dhe prekin shumë nene, edhe pse parimet bazë të ligjit mbeten, hartuesi duhet të mendojë mbi mundësinë e një ligji të ri, por jo domosdoshmërisht. Një nga parimet bazë të hartimit të mirë është qartësia dhe një ligj me shumë ndryshime mund të mos jetë i qartë. Në çdo rast, hartuesi nuk duhet të përgatisë një ligj krejtësisht të ri, për të zëvendësuar një ligj ekzistues, pa arsye të forta dhe të mirë menduara”. Po aty janë përcaktuar konkretisht hapat që duhet të ndiqen për hartimin e një projekti të ri legjislativ:			mbi rregullimin e veprimtarisë së shërbimit të jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, në të cilin përcaktohet grupi i punës me përbërjen si më poshtë: • Zëvendësm inistri për evropën dhe punët e jashtme, përgjegjës për çështjet e integritetit evropian, kryetar; • Ambasador i i Republikës së Shqipërisë pranë Misionit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian, anëtar; • Drejtor i drejtorisë së Burimeve Njerëzore, anëtar; • Drejtor i drejtorisë së organizatave ndërkombëtare, anëtar; • Drejtor i drejtorisë për të drejtën e detit dhe marrëdhëniet me gjykatat ndërkombëtare, anëtar; • Drejtor i drejtorisë së të drejtës ndërkombëtare dhe traktateve, anëtar; • Drejtor i drejtorisë së çështjeve konsullore, anëtar;
--	--	--	--	---

	• Identifikimin dhe përcaktimin e qartë të problemit dhe objektivave politikë të cilat akti normativ do t'i rregullojë; • Identifikimin e disa mënyrave (formave ligjore dhe jashtë kuadrit ligjor) dhe zgjedhjen e njërës prej tyre për të adresuar problemin; • Mbledhjen e të dhënave dhe identifikimin e grupeve të interesuara; • Konsultimin me të gjitha grupet e interesuara; • Vlerësimin paraprak si dhe të mëpasshëm (<i>ex ante/ex post impact assessment</i>) që në vetvete përfshin realizimin e analizës kosto-përfitim të pasojave që do të sjellë si dhe ka sjellë akti. Relacioni që shoqëron aktin nuk ka asnjë analizë të tillë dhe në mungesë të tij mund të vijnë në ndihmë procesverbalet e diskutimeve të grupit të punës. Pyetje: A është e mundur që këto procesverbale të ndahen me anëtarë të shërbimit të jashtëm që mund të kenë interes për informimin mbi to? Sipas Manualit: “Gjatë marrjes së vendimit për një projekt të ri legjislativ, është e dobishme që të konsultohen përvojat e vendeve të tjera. Megjithatë, përvojat e vendeve të tjera nuk duhen marrë si të mirëqena. Ato duhet të analizohen dhe të shqyrtohen duke marrë në konsideratë kushtet dhe rrethanat specifike të realitetit shqiptar. Adoptimi i një modeli të huaj apo i një rregullimi ligjor të huaj pa marrë në konsideratë realitetin vendas mund të çojë në zgjidhje legjislative të gabuara.” Pyetje: A mundet që grupi i punës të informojë se ne cilat modele e ka mbështetur hartimin e projekt-ligji? Që nga viti 2018, procesi i vlerësimit paraprak të nevojës, alternativave dhe mënyrës së ndërhyrjes legjislative bëhet edhe nëpërmjet përgatitjes së RVN (Raporti I Vlerësimit të Nevojave) gjatë procesit të vlerësimit së ndërhyrjes. RVN-ja është një metodë analitike e zhvilluar vitet e fundit në shumë vende të tjera në Evropë, SHBA dhe Kanada. Kjo metodë përdoret për përmirësimin e			• Drejtor i drejtorisë së shërbimeve të përgjithshme, anëtar; • Drejtor i drejtorisë së buxhetit dhe menaxhimit financiar, anëtar; Në këtë urdhër përcaktohet se në mbledhjen e grupit të punës mund të ftohen përfaqësues të institucioneve, sipas rendit të mbledhjeve, kontributi i të cilëve vlerësohet i domosdoshëm në hartimin e projekt-akteve, si Departamenti i Administratës Publike, Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, Drejtoria e Përgjithshme e Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit në Ministrinë e Drejtësisë, ekspertë të jashtëm si dhe përfaqësues të drejtorive të tjera në MEPJ. Ligji në fuqi ka dëshmuar një numër dobësish përgjatë periudhës gati 10 vjeçare të zbatimit të tij, të cilat kanë lidhje me defekte në
--	--	--	--	---

	cilësisë së legjislacionit, në drejtim të efikasitetit, efektivitetit dhe ndikimit në shoqëri pas miratimit të tij. RVN-ja përbën një pjesë integrale të procesit legjislativ. Nëse një problematikë e caktuar nuk analizohet në të gjithë përbërësit e tij, analizë e cila sigurohet nga kjo metodë, qartësia e dispozitave që eventualisht mund të rregullojnë atë problem mund të komprometohet, duke ndikuar në zbatimin e tyre. Pyetje: A mundet grupi i punës të ndaje RVN e përgatitur për këtë projekt-akt?			mekanizimin e karrierës diplomatike, në statusin e diplomatëve të ardhur nga jashtë sistemit, në garantimin e kualifikimit e përshtatshëm profesional, në promovimin e diplomatëve të karrierës në postet diplomatike dhe në harmonizimin më të mirë midis veprimtarisë së diplomatit me shkallët e karrierës, përfitimet dhe privilegjet respektive. Ligji është bazuar në disa ligje të vendeve anëtare të Bashkimit Europian si ligji për shërbimin e jashtëm i republikës së sllovenisë, hungarisë, reformës të ndërmarrë nga Franca për shërbimin e jashtëm, por gjithmonë duke i përshtatur këto modele me nevojat dhe sfidat e shërbimit të jashtëm të Republikës së Shqipërisë. Ligji i kanë munguar mekanizmat e nevojshëm eficientë për të realizuar ndërveprimin institucional dhe për të garantuar rolin koordinues dhe mbikëqyrës të ministrisë përgjegjëse për
--	---	--	--	---

				punën e jashtme në veprimtarinë me jashtë të institucioneve të tjera qendrore dhe vendore. Ligji nuk kishte parashikuar mundësinë për ngritjen e strukturave arsimore ose kualifikuese në fushën e marrëdhënieve me jashtë, gje që ka penguar specializimin në masën e duhur të personelit të shërbimit të jashtëm. Ligji ka pasur nevojë të përditësohej dhe të harmonizonte dispozitat me legjislacionin më të ri, i cili prekte aspekte të veçanta të fushës së tij të rregullimit (p.sh. përkufizimi i saktë i ndalimeve që burojnë nga pastërtia e figurës). Ligji ka pasur nevojë të rregullonte një numër mangësish dhe paqartësish në zbatimin e statusit të diplomatit dhe të familjes së tij, të formulonte në mënyrë korrekte frazeologjinë dhe terminologjinë e përdorur për një numër konceptesh specifike të fushës dhe të rregullonte disa probleme të teknikës legjislative (p.sh. përkufizimi i anëtarit të familjes së diplomatit, përkufizimi
--	--	--	--	---

				koherent i ministrisë dhe i ministrit përgjegjës për punët e jashtme). Problemi ka qenë i identifikuar qartë dhe ka qenë i qartë për të gjithë kontributorët, sikurse ka qenë jashtë çdo dyshimi, se përmirësimet mund të bëheshin vetëm nëpërmjet ndërhyrjes legjislative. Amendamentet prekin faktikisht shumicën e neneve të ligjit. Prandaj justifikohet formatimi i tyre si një ligj i ri. Kjo gjë është në përputhje të plotë me teknikën legjislative që referon manuali i hartimit të legjislacionit.
Komente mbi projektligjin dhe pasojat që sjellin ndryshimet e propozuara (sugjerimet konkrete në vijim të komenteve të përgjithshme janë shënuar përbri neneve korrespondues e)	Duke mbajtur parasysh ecurinë mbi 30 vjeçare të Shërbimit të Jashtëm, ndryshimet ligjore të bëra në kohë të ndryshme dhe problematikat e ndeshura, si ato që lidhen me formulime ligjore të papërshtatshme ashtu dhe me moszbatimin korrekt të legjislacionit në fuqi, Këshilli i Ambasadorëve Shqiptarë ka bindjen se Shërbimi i Jashtëm ka nevojë për rregullime ligjore të qenësishme, sikurse dhe për krijimin e kulturës së interpretimit dhe zbatimit korrekt, në frymë dhe germë, të legjislacionit në fuqi. KASH, me dëshirën për të kontribuar në përpilimin dhe miratimin e një ligji sa më të mirë për Shërbimin e Jashtëm, që t'i rezistojë kohës dhe të patur një trupë diplomatike të karrierës në RSH, mbas një konsultimi të gjerë brenda anëtarëve tij, duke iu referuar praktikave më të mira në rajon dhe në vendet e BE-së, dhe duke vlerësuar në parim shqetësimin	KASH	Refuzuar	Modifikimet e propozuara janë neutrale ndaj aksesit në shërbim të diplomatëve nga jashtë sistemit. Aksesit nga jashtë sistemit ka qenë i parashikuar në ligjin në fuqi, me të njejtat formulime. Modifikimet synojnë në këtë kontekst që të rregullojnë vetëm statusin dhe disiplinën e prurjeve nga jashtë sistemit shtetasve shqiptar të cilët kanë eksperiencë pune

	dhe qëllimin e shprehur për rregullimet dhe përmirësimet e synuara në këtë Projekt-ligj, shpreh mendimet si më poshtë: Së pari, lidhur me FRYMËN e tij, Këshilli i Ambasadorëve Shqiptarë gjykon se Projekt-ligji për Shërbimin e Jashtëm i hedhur për diskutim publik, në tërësi dhe me disa nene të veçanta, në vend që t'i shërbejë forcimit dhe modernizimit të diplomacisë së karrierës, ai e zhvesh dhe më shumë atë nga ana profesionale, duke e kthyer në një ligj klientelizmi politik dhe partiak, ku përfaqësues të këtyre të fundit, të veshur me kostumin e diplomatit do ta kthenin këtë shërbim karriere në diplomaci partiake, duke dëmtuar rëndë investimin e madh profesional të bërë ndër dekada. Gjykojmë se në relacionin përkatës duhej të ishte pasqyruar se çfarë nuk ka funksionuar siç duhet me legjislacionin ekzistues, çfarë duhet përmirësuar, dhe mbi bazën e cilave parime do bëhen këto përmirësime. Në relacion argumentohet se "...ka ndryshuar situata gjeopolitike...". KASH ka bindjen që ky argument nuk qëndron, sepse Ligji i Sh.J. në rradhë të parë rregullon organizimin dhe funksionimin e vetë sistemit të Shërbimit të Jashtëm, si dhe marrëdhënien dhe bashkëpunimin e këtij sistemi me institucionet e tjera, si Presidenti i Republikës, Kuvendi, Këshilli i Ministrave, ministritë, institucionet qendrore dhe organet e qeverisjes vendore etj, dhe me publikun. Ndryshimi i situatave gjeopolitike (gjithsesi të pashtjelluara në relacion) nuk mund dhe nuk duhet të ketë ndikimin e pretenduar në ndryshimet që synohet të bëhen nëpërmjet këtij Projekt-ligji. Vërejmë gjithashtu se relacioni që shoqëron këtë projektligj është në masë të madhe kopje e relacionit që ka shoqëruar procesin e miratimit të ligjit që është sot në fuqi. Nëse nuk ka argumente të reja, ato të kaluarat pretendohet që duhet të ishin zgjidhur me ligjin e miratuar në vitin 2015.			në organizata ndërkombëtare publike në funksione ekzekutive ose drejtuese, si dhe kushtet dhe kriteret për transferimin brenda shërbimit të karrierës, në përfundim të misionit diplomatik ose konsullor. Ministria beson se integrimi në shërbimin e karrierës është instrument depolitizimi, i cili nxit diplomatët, të cilët vijnë nga jashtë sistemit, që t'i përkushtohen kultivimit të një perspektive profesionale afatgjatë. Prurjet nga jashtë sistemit, me larminë e eksperiencave dhe cilësive individuale, bëhen pasuri për shërbimin diplomatik kur ato integrohen brenda shërbimit dhe profilizohen si pjesë e tij. Ministri është titullari i institucionit, organi i vetëm vendimmarrës i tij. Ligji nr. 90/2012, i cili referohet nga KASH, i njeh ministrit jo vetëm kompetencën për "drejtimin politik", por edhe "drejtimin e punës administrative dhe kontrolluese
--	---	--	--	---

	Në tërësinë e vet, ndryshimet e propozuara sjellin së paku këto pasoja të rënda: Forcon tej mase rolin e Ministrit, në çështje që nuk janë të kategorisë “drejtim politik”, duke rënë ndesh me parashikimet e Ligjit Nr. 90/2012 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore”, Kreu III, Neni 1 i të cilit përcakton që “Ministria drejtohet nga ministri, i cili drejton politikën shtetërore për fushën që mbulon punën administrative dhe kontrolluese në institucion”. Pra Ministri bën drejtimin politik, jo drejtimin administrativ të institucionit. Në kundërshti me këtë, ky Projekt-ligj i jep Ministrit kompetenca të gjithëfuqishme vendimmarrëse në çështjet e ecures së karrierës së diplomatëve, pranimeve në Shërbimin e Jashtëm të “specialistëve” jashtë sistemit, dhe të emërimeve në Ministri dhe në Përfaqësitë jashtë vendit. Përveçse në kundërshtim me ligjin e sipërpërmendur, ky fakt bie ndesh edhe me synimet e reformimit të administratës publike dhe forcimit të pavarësisë dhe profesionalizmit të sistemeve të karrierës. Në linjë me komentin e mësipërm, vërejmë një zbehje të skajshme të rolit të Sekretarit të Përgjithshëm, duke e reduktuar rolin e tij nga drejtues kryesor i sistemit të karrierës dhe të funksionimit administrativ të institucionit, në një nëpunës të rëndomtë që nuk ka as kompetencën formale të propozimit të emërimeve në sistemin e Shërbimit të Jashtëm. Në versionin e hedhur për diskutim, është parë e arsyeshme që Sekretari i Përgjithshëm të mos parashikohet fare as të jetë anëtar në strukturat administrative, si p.sh. në Komisionin e Gradave dhe Disiplinës, të cilat me legjislacionin aktual i drejton <i>ex officio</i>. Është propozim i drejtë që strukturat e kësaj kategorie të ngrihen me urdhër Ministri. Por vërejmë me keqardhje që pasi të jenë ngritur, këto struktura do jenë në varësi të ministrit duke i bërë plotësisht të varura nga ndikimi politik. Shumë shqetësues është fakti se ky Projekt-ligj dobëson sistemin e			në institucion”. Çështjet e ecures së karrierës së diplomatëve, të pranimeve në shërbimin e jashtëm dhe të emërimeve në ministri dhe në përfaqësitë jashtë vendit janë funksion tipik i tiutllarit të institucionit. Kjo është e njëjtë për të gjitha institucionet në Republikën e Shqipërisë. Neni 15 i ligjit 90/2012 e përcakton sekretarin e përgjithshëm si nëpunësin më i lartë civil në një ministri, i cili raporton dhe jep llogari drejtpërdrejt te ministri. Sekretari i Jashtëm, përveç përgjegjësive të parashikuara në legjislacionin në fuqi, është përgjegjës për: a) administrimin e burimeve njerëzore dhe financiare në Shërbimin e Jashtëm; b) bashkërendimin dhe menaxhimin e ruajtjes së marrëdhënieve me institucionet e tjera shtetërore ;c) bashkërendimin dhe menaxhimin e aktiviteteve të Ministrisë në
--	--	--	--	---

	karrierës diplomatike në favor të vendimeve arbitrare dhe hyrjeve të pakontrolluara në sistem. Kjo sjell dëm sistemik, duke ulur interesimin e kandidaturave të mira për diplomatë karriere pa mbështetje politike apo njohje personale, rrjedhimisht edhe të cilësisë së personelit diplomatik. Në disa nene të veçanta të Projekt-ligjit, shohim me keqardhje se shqetësimi dhe meraku më i madh është përshtatja e ligjit dhe rregullave përkatëse ndaj akomodimit të nevojave në rritje për zgjerimin e diplomacisë sonë, tashmë <i>nga jashtë</i>, në dëm të shërbimit përcaktues të karrierës <i>nga brenda</i>. Ndërkohë që forcohen më tej kushtet, kriteret dhe kërkesat për diplomatët dhe titullarët e karrierës, ato liberalizohen dhe lehtësohen ndjeshëm për kooptimin e diplomatëve nga jashtë, duke krijuar një pabarazi dhe padrejtësi sociale të dëmshme. Një përjasje e tillë, e cila gjen vend gjerësisht në p/ligjin e ri të propozuar, i lë në hije diplomatët e karrierës të formuar ndër vite, me synim eliminimin shkallë shkallë të kësaj trupe profesioniste, për t'i hapur vend një <i>shtrese të re diplomatësh</i>, që pritet të rekrutohen ose më mirë të themi kooptohen, të cilët do të marrin atributet e <i>karrierës</i>, duke zëvendësuar të tanishmit dhe duke kapur poste drejtuese në diplomacinë shqiptare, pa patur pothuajse fare përvojë - cilësi e domosdoshme në diplomaci. Nisur nga kjo frymë dhe nevoja për shmangien e dukurisë së lartpërmendur, jemi dakord dhe mbështesim procedurat e vlerësimit në punë të çdo diplomati, kompetencat e drejtorëve politike në MEPJ, në raport me vartësit e tyre dhe të Ambasadorëve në raport me diplomatët në varësi në përfaqësitë apo misionet diplomatike. Ndërkohë që duhet të forcohet sistemi i dhënies së gradave diplomatike, ai të jetë i mirë-motivuar dhe sipas një piramide të mirë-studiuar të gradave. Çdo vend pune duhet të jetë në pajtueshmëri të plotë me nivelin e gradave diplomatike dhe diplomati i karrierës duhet të jetë i motivuar në rrugën e tij të rritjes profesionale, ashtu siç duhet të mbajë përgjegjësi për mos			kuadër të procedurave të menaxhimit të brendshëm; ç) Çdo detyrë tjetër të përcaktuar në këtë ligj. Ky pozicion i lartë në administratën civile konfirmohet edhe nga projektligji (neni 18). Rrethi i detyrave ia kërkon sekretarit të përgjithshëm të veprojë si mbikëqyrës dhe koordinator mbi strukturat e brendshme. Pozicioni i tij ligjor është pozicioni i një eprori në raport me komisionin e karrierës diplomatike dhe disiplinës. Funkcioni i sekretarit të përgjithshëm është funksion ekzekutiv, në mbështetje të ministrit. Në projektligj Sekretari I Përgjithshëm është vendosur të drejtojë Komisionin e Apelit. Trupa diplomatike rrit
--	---	--	--	---

	realizim të detyrave, e reflektuar kjo dhe në ecurinë e karrierës diplomatike. Goditja ndaj diplomacisë së karrierës në Projekt-ligjin për shërbimin e jashtëm që propozohet, pasqyrohet dhe realizohet nëpërmjet formave të mëposhtme (dhe jo vetëm): përmbykses së butë të raporteve midis diplomacisë së karrierës dhe të ashtuquajturës diplomaci e rrugës/outsiders; nëpërmjet uljes së nivelit të gradave diplomatike për ata që do të vijnë nga jashtë sistemit dhe emërimit të tyre të pritshëm në poste të larta drejtuese në MEPJ apo misione/përfaqësi diplomatike jashtë vendit; nëpërmjet heqjes së fashave kufizuese për ata që do të emërohen si Titullarë Misionesh, duke synuar shtrirjen e trupës së anti-karrierës dhe në poste drejtuese brenda MEPJ, etj. Për fat të keq dhe në mënyrë të pajustificueshme, kjo tendencë negative po synohet të ligjërohet në një kohë kur gjatë dekadave të fundit, siç dihet, vendi ynë, me ndihmesën e dukshme dhe të shërbimit diplomatik, ka shënuar disa arritje madhore – anëtarësimi në KiE, nënshkrimi i MSA-së, antërarësimi në NATO, liberalizimi i vizave, mbështetja e pakufishme dhe kontributi esencial e profesional në pavarësinë e Kosovës, për të vijuar me kryesimin e KiE-së, të OSBE-së, anëtarësimin dhe kryesimin e KS të OKB-së, sigurimi i statusit kandidat dhe çelja e negociatave të anëtarësimin në BE, etj. Këto dhe fakte të tjera dëshmojnë se tanimë kemi një diplomaci karriere të konsoliduar dhe me përvojë, me diplomatë dhe ambasadorë të profilit ndërkombëtar, me disa mandate jashtë vendit, të cilët janë në poste drejtuese në MEPJ, pa harruar një numër të konsiderueshëm prej tyre që kanë kontribuar ndër vite në MEPJ e që për arsye të ndryshme janë jashtë saj, por ende kontribues e aktiv në këtë fushë. Për rrjedhojë, emërimi i ambasadorëve politikë nga jashtë sistemit dhe ca më pak përfshirja e tyre në shërbimin e karrierës është bërë shumë më pak e nevojshme se vite më parë. Gjithsesi, caktimi si titullarë përfaqësish të personaliteteve të spikatura të artit,			cilësinë, nëse garanton një mekanizëm prurjesh cilësore dhe një mekanizëm eficient kualifikimi dhe seleksionimi përgjatë karrierës. Për një vend të vogël si Shqipëria është domosdoshmëri që të mbahet e hapur rruga e ushqimit të sistemit me prurje nga jashtë, sepse kapacitetet formuese të vetë sistemit janë nga natyra të reduktuara dhe të avashta. Sistemi i brendshëm kualifikues mund prodhojë lehtësisht nëpunës, por e ka të vështirë që me kurrikulën e vet të kultivojë dijet, aftësitë, shprehitë dhe kulturën njerëzore dhe diplomatike që kërkon një nivel i lartë diplomatik. Jashtë sistemit ka individë të cilët i disponojnë në nivele të larta një pjesë prej këtyre cilësive, ose njerëz që e kanë siguruar kualifikimin më të lartë për shkak të karrierave personale jashtë shërbimit diplomatik të Shqipërisë. Këta individë duhet të shihen nga ligji dhe nga shërbimi ynë diplomatik si asete të çmuara që
--	---	--	--	---

	kulturës, letërsisë, botës akademike dhe sportit është i mirëpritur; veçse kjo në ligj të kufizohet deri në 10 përfaqësi të rëndësishme për një mision dhe periudhë të caktuar kohe. Por jo siç ka ndodhur që të kooptohen nga jashtë dhe pastaj të vazhdojnë karrierën diplomatike pa konkurim, në dëm të diplomatëve profesionistë që ia kanë kushtuar jetën e tyre diplomacisë. Kujtojmë se deri para 10–15 vitesh Ligji i Sh. J. sanksiononte kuotën 20% për Ambasadorët jashtë sistemit. E vërteta është se kjo kuotë nuk respektohej, por minimalisht kishte një barrierë e cila ishte si referencë për kritikën përkatëse. Ligji i 2015-ës dhe Projekt-ligji në fjalë duhet të forconte zbatueshmërinë e kësaj kuote dhe jo ta asgjësonte tërësisht atë, në kundërshtim me çdo praktikë ndërkombëtare e ligjet e atyre vendeve, grupimit të të cilëve aspirojmë ti bashkohemi. Mbështetur sa parashtruam edhe në paragrafet e mësipërme, ky Projekt-ligj duhet ta ulë deri në 15 për qind këtë kuotë. Në asnjë mënyrë nuk mund ta lerë pa asnjë kufi. Kjo i hap rrugë abuzimeve. Nisur nga sa sipër, nëse fryma e këtij Projekt-ligji është vërtet forcimi i profesionalizmit dhe diplomacisë së karrierës, synim që ky Ligj ka patur qëkurse u hartua për herë të parë në vitin 1998, atëherë sistemin e karrierës nuk duhet ta përcaktojë e ta drejtojë Ministri përgjegjës, por vetë diplomacia e karrierës, nëpërmjet komisioneve përkatëse, të drejtuara nga Sekretari i Përgjithshëm. Sa për marrëdhëniet me Kryeministrinë, Presidencën, Kuvendin dhe dikasteret e tjera, projekti nuk sjell asgjë të re, me përjashtim të ndryshimit të vendeve dhe ndonjë formulimi ndryshe por pa ndryshim në substancë. Ose për të argumentuar nevojën e një ligji të ri. Madje, referenca të caktuara në lidhje me këto marrëdhënie janë antikushtetuese. Fatkeqësisht, Projekt-ligji nuk ndryshon as non-sensin kushtetues të Ligjit të 2015-ës, i cili kushtëzon politikisht në kohë firmën kushtetuese të Presidentit të Republikës në		duhet të përthithen dhe jo të paragjykoen si të “politizuar” thjesht dhe vetëm se përthithja e tyre bëhet nga një administratë e caktuar. Jashtë sistemit dhe pa mundësi për të penetruar në sistem ndodhen sot një numër i konsiderueshëm shtetasish shqiptarë, të cilët kanë kryer një karrierë të admirueshme, deri në nivelet më të larta të shërbimit në organizata të ndryshme ndërkombëtare. Rrethana specifike jetësore mund t’i rikthejnë një pjesë prej tyre në atdhe dhe mund të favorizojnë përthithjen e tyre nga shërbimi diplomatik shqiptar. Projektligji krijon hapësirën që një gjë e tillë të bëhet e mundur. Ky mekanizëm fuqizon shërbimin, rrit ndjeshëm cilësinë e trupës dhe forcon konkurrencën e shëndoshë midis diplomatëve. Sfida politike e sistemit është si të përthithë më të mirët, më të aftët, më rezultativët, jo si të përthithë më “besnikët”. Besnikëria politike nuk është
--	---	--	---

	emërimin dhe lirim in e Ambasadorëve. Kësisoj, projekti nuk përmban ndonjë risi, ca më pak të rëndësishme. Edhe përcaktimi i afatit kohor prej 4 vitesh dhe jo më shumë se dy mandate 8 vjet, ka qenë në ligjin përpara vitit 2015, por u hoq si “risi”. E njëjta gjë mund të thuhet për paragrafë të tjerë si “sigurimi i pastërtisë së figurës”, etj., si këto, të cilat kanë qenë dhe në ligjet e mëparshme. Gjithashtu, ndryshe nga çdo përvojë e vendeve të BE (ku ne duam të bashkohemi), lihet në heshtje kriteri i mbajtjes nga diplomati vetëm të shtetësisë shqiptare. Përveç se në kundërshtim me praktika ndërkombëtare të gjithë pranuar, të sanksionuara edhe në Konventën e Vjenës për Marrëdhëniet Diplomatike të vitit 1961, kjo bie ndesh me formulën e betimit të diplomatit (neni 44, pika 2 e Projekt-ligjit). Nisur nga sa sipër dhe duke bërë krahasimin me Ligjin e vitit 2015, mendojmë se është më e drejtë të flitet për “Ndryshime në Ligjin 2015” se për një Ligj të ri, por që nuk zgjidhin problemet sistemike të grumbulluara ndër vite të Shërbimit të jashtëm.		kriter për zgjedhjeje. Nga ana tjetër, përfshirja e politikës në përzgjedhje nuk e politizon përzgjedhjen. Ndryshe nuk do ishte e pranueshme p.sh. që në procedurën e emërimit të ambasadorët të përfshihej komisioni parlamentar për politikën e jashtme, strukturë e formuar tërësisht nga politikanë. Projektligji propozon ngritjen e akademisë diplomatike me qëllim që të rrisë forcën e instrumenteve të brendshëm kualifikues, parakusht për të ulur peshën specifike të prurjeve nga jashtë. Në të vërtetë, masat e propozuara synojnë që të rrisin aftësitë seleksionuese të mekanizmave të karrierës, me qëllim që promovimi të bëhet bazuar vetëm në meritë. Përmirësimi i ndjeshëm në të dy këto drejtime do të rrisë cilësinë e komponentit të karrierës në shërbimin
--	---	--	---

			diplomatik dhe do të ulë nevojën relative për të ushqyer shërbimin me prurje nga jashtë. Ky është proces evolutiv, i cili nuk ndihmohet dot nga politika e “kuotave” në shërbim, por nga zbatimi me konsekuencë i mekanizmave që rrisin cilësinë e trupës, deri kur sistemi i brendshëm të jetë konkurrues dhe konkurrenca t’a bëjë të panevojshëm shfrytëzimin e mekanizmit të prurjeve nga jashtë. Mekanizmi ligjor i propozuar është i drejtë, rezultativ dhe i barazpeshuar. Karriera e diplomatëve të përthithur nga jashtë sistemit, pranë organizatave ndërkombëtare, ekuivalentohet me një mekanizëm racional ekuivalentimi me sistemin tonë të gradave. E reja e rëndësishme sa i takon bashkëpunimit ndërinstitucional qëndron në faktin
--	--	--	--

				se projektligji ka përcaktuar një mekanizëm konkret dhe efikas për realizimin e rolit bashkërendues dhe kontrollues që ligji në fuqi i ka caktuar ministrisë përgjegjëse për punët e jashtme. Ky mekanizëm qëndron tek koordinatorët (neni 11), të cilët janë diplomatë karriere, pjesë e shërbimit të jashtëm që zhvendosen me afat të caktuar pranë institucioneve dhe kujdesen për plotësimin e detyrimeve ligjore për bashkërendim dhe raportim. Nuk ka asnjë referencë antikushtetuese në këto marrëdhënie. Procedura për emërimin ose lirimin e ambasadorëve është procedurë administrative. Kjo procedurë, si çdo procedurë administrative, shoqërohet me afate. Procedura nis me Kryeministrin, i cili zyrtarizon propozimin dhe përfundon me komisionin parlamentar për politikën e jashtme, i cili jep pëlqimin në emër të Kuvendit. Përveç afatit 30 ditor të Presidentit të Republikës, procedura përmban dhe
--	--	--	--	--

				afatin për shqyrtimin nga komisioni parlamentar për politikën e jashtme. Thjesht ky afat përcaktohet në rregulloren e brendshme të Kuvendit. Përcaktimi i afatit 30 ditor nuk cenon kompetencën kushtetuese të Presidentit të Republikës. Afati 30 ditor është i mjaftueshëm për shqyrtimin e kandidaturës dhe për sqarimin e të gjitha rezervave lidhur me të. Mënyrën se si Presidenti i Republikës dhe Kryeministri bashkëpunojnë për kryerjen e këtij procesi e ka sqaruar në mënyrë ezauruese Gjykata Kushtetuese me vendim të posaçëm.
Neni 1 “Qëllimi”	Te ruhet raporti i hierarkisë së normave. Ndërhyrje me <i>track changes</i> në tekstin e projektligjit: Të hiqet fraza “... dhe aktet ligjore në zbatim të tij, kanë”.	Suela J.	Pranuar	
Neni 3 “Përkufizime”	Neni 3, pikat 1 dhe 2 , krijojnë një ndarje me përkufizimet e dhëna, ndërmjet “diplomatit të karrierës” dhe “diplomatit (jashtë sistemit të karrierës)”, prandaj ose kudo në ligj duhet të referohen të dy termat, ose tek përkufizimi i termit diplomat të përfshihet edhe diplomati i karrierës.	Marsida K.	Refuzuar.	Në këtë pikë të projektligjit shkruhet, se “Diplomat” është çdo person, i cili bëhet pjesë e Shërbimit të Jashtëm të Republikës së Shqipërisë, sipas kriterëve të

				caktuara në këtë ligj dhe që gëzon statusin e diplomatit për sa kohë është pjesë e tij. Ky përkufizim përfshin dhe diplomatët e karrierës. Është rishikuar i gjithë teksti në mënyrë që të referohen termat saktësisht.
Neni 3, Pika 14 “Anëtarët e familjes së diplomatit”	Duke qenë se projekt-ligji në masë dërmuese është transferim i tekstit të ligjit aktual, po referohen vetëm ndryshimet e paraqitura në projekt, disa prej të cilave në vlerësimin tim personal, janë pozitive dhe disa të tjera kanë nevojë për konsiderim dhe konsultim të mëtejshëm: Ndër elementët pozitive të draftit të ri janë: 1. Zgjerimi i konceptit të anëtarit të familjes së diplomatit “Anëtarë të familjes së diplomatit” janë bashkëshorti/ja, fëmijët deri në moshën 23 vjeç, fëmijët me aftësi ndryshe pa kufizim moshe, si dhe personat e tretë në kujdestarinë e tij/saj ligjore. Megjithatë edhe në këtë aspekt, duke u përshtatur me kërkesat e kohës, duhet diskutuar mundësia e përfshirjes së konceptit të bashkëjetesës, sipas formës së njohur nga ligji- neni 163 i Kodit të Familjes.	Suela J.	refuzuar	Në vijim të një vlerësimi me strukturat përkatëse, termi “bashkëjetues” nuk është vendosur në projektligj pasi bie ndesh me nenin 13 të ligjit nr. 10129/2009 i ndryshuar 6/2024 “Për gjendjen civile”, në të cilën përkufizohen 4 gjendje civile të personit: beqar, i martuar, i ve, i divorcuar.
Neni 6 “Funksionet e Shërbimit të Jashtëm”	Në Nenin 6, pika 2. C, duhet të shtohet dhe fusha e bashkëpunimit konsullor.	KASH	Pranuar	Riformuluar: c) zhvillon marrëdhënie politike, ekonomike, sociale, konsullore dhe kulturore me vende të tjera;
Neni 7 “Bashkëpunimi me Presidentin e Republikës”	Në nenet 7, 8 dhe 9, duhet përcaktuar në ligj se, në kuadër të bashkëpunimit midis MEPJ dhe Presidencës, Kuvendit dhe KM-së, është me rëndësi dhe informimi i MEPJ-së, lidhur me aktivitetin diplomatik të kryer nga këto institucione	KASH	Pranuar	Në nenin 7 është shtuar një paragraf me këtë përmbajtje: “3. Presidenti i Republikës, sipas

Neni 8 “Bashkëpunimi me Kuvendin”	të larta shtetërore, ashtu siç përcaktohet në Nenin 10, pika 5.			rastit, informon Ministrin për çështje të rëndësishme në interes të Shërbimit të Jashtëm dhe politikave të jashtme të Republikës së Shqipërisë.” Formulimi si më sipër është shtuar edhe në pikën 3 të nenit 8.
Neni 9 “Bashkëpunimi me Kryeministrin”	Bashkëpunimi me KM është një dispozitë e re që propozohet, për të cilën gjykoj se është e panevojshme dhe nuk duhet përfshirë në projekt. Titulli i kësaj dispozite është non-sens juridik. Ministri është pjesë integrale e pushtetit ekzekutiv të përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave nën drejtimin e KM. KM dhe ministri nuk mund të kenë marrëdhënie bashkëpunimi, të së njëjtes forme të përcaktuar me organet e pushteteve të tjera. Marrëdhënia e Ministrit me KM rregullohet nga dispozita kushtetuese, neni 102 i Kushtetutës sipas së cilës KM bashkërendon dhe kontrollon punën e anëtarëve të Këshillit të Ministrave. Po ashtu në mënyrë më të detajuar, kjo marrëdhënie rregullohet në ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”.	Suela J.	Refuzuar	Dispozita përcakton detyrime që lidhen me karakterin specifik të politikës së jashtme dhe rolin e posaçëm që i takon kësaj ministrie në funksion të qendrueshmërisë, koherencës dhe bashkërendimit të politikave qeveritare në fushën e marrëdhënieve me jashtë. Dispozita njeh detyrimin e ministrit për të raportuar posaçërisht për shkallën e bashkëveprimit ndërinstytucional dhe për të kërkuar marrjen e masave nga niveli më i lartë i pushtetit ekzekutiv, në rast se institucionet nuk u përgjigjen detyrimeve për bashkëveprim. Për këto arsye, dispozita është e nevojshme. Gjithsesi, ajo nuk bie ndesh as me

				Kushtetutën, as me ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave” pasi është një dispozitë që parashikon në vija shume të përgjithshme bashkëpunimin ndërmjet KM dhe Ministrit në fushën e shërbimit të jashtëm, pa krijuar mbivendosje apo qene në kundërshtim me ligjin Nr. 9000, datë 30.1.2003. Gjithashtu, neni 6 i ligjit parashikon mundësinë që çështje të tjera të rregullohen me ligje të posaçme.
Neni 11 “Bashkërendimi institucional”	Kjo dispozitë mbulon të njëjtën situatë si ajo e parashikuar në nenin 45 sipas së cilës: Diplomati i karrierës mund të punësohet në pozicione që mbulojnë marrëdhëniet me jashtë në institucionet kushtetuese dhe administratës shtetërore pas marrëveshjes përkatëse ndërmjet Ministrisë dhe këtyre institucioneve. Duhet rishikuar evitimi i perseritjeve, duke gjetur në vlerësim më të saktë nenin 45.	Suela J.	Refuzuar	Në nenin 11 rregullohet mekanizmi i bashkërendimit ndërinstitutional duke përcaktuar koordinatoret), të cilët janë diplomatë karriere, pjesë e shërbimit të jashtëm që zhvendosen me afat të caktuar pranë institucioneve dhe kujdesen për plotësimin e detyrimeve ligjore për bashkërendim dhe raportim. Në nenin 45 rregullohen të drejta dhe detyrime të diplomatit të karrierës në raport me punësimin e tij me marrëveshje ndërmjet titullarëve të dy

				institucioneve. Të dy dispozitat janë në harmoni me njëra tjetrën dhe duhet të bashkekzistojnë.
Neni 15 “Ministria”	Neni 15, pika 2, shkronja “c” duhet të rishikohet në raport me nenin 26, pika 1, pasi misionet e përbashkëta dhe misionet e posaçme janë misione diplomatike dhe kemi përsëritje, ndërkohë nuk ka referenca në ligj të “misioneve të përhershme”.	Ejona H.	Pranuar	Në përgjigje të kësaj vërejtjeje është marrë në konsideratë modifikimi i tekstit në këto drejtime, në nenin 15, pika 2, gërma “c”: drejton dhe bashkërendon veprimtarinë e misioneve diplomatike dhe posteve konsullore
	Neni 15, pika 2, shkronja “ç” , që parashikon si funksion të Ministrisë ndjekjen e procedurave për lidhjen e akteve ndërkombëtare, si dhe anëtarësimin e Republikës së Shqipërisë në organizatat ndërkombëtare, sugjeroj të shtohet një frazë në fund të kësaj fjalie “... brenda fushës së saj të përgjegjësisë”, për të qenë në përputhje edhe me ligjin nr.43/2016 “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.	Ejona H.	Pranuar pjesërisht	Riformuluar: <i>ç) ndjek procedurat për lidhjen e akteve ndërkombëtare, si dhe anëtarësimin e Republikës së Shqipërisë në organizatat ndërkombëtare, sipas legjislacionit në fuqi që rregullon marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë.</i>
	Neni 15, pika 2/ç , në përputhje me ligjin nr. 43/2016 “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë” procedurat për lidhjen e akteve ndërkombëtare, si dhe anëtarësimin e Republikës së Shqipërisë në organizatat ndërkombëtare, ndiqet nga institucionet kompetent, duke marrë në çdo rast mendimin e MEPJ.	Marsida K.	Pranuar pjesërisht	Riformuluar si më sipër.
	Neni 15, pika 2/d , në përputhje me ligjin nr. 43/2016 “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, neni 13, pika 4, krahas marrëveshjeve origjinale të lidhura në emër të shtetit dhe Qeverisë shqiptare, në MEPJ depozitohen edhe marrëveshjet ndër-institucionale.	Marsida K.	Pranuar pjesërisht	Riformuluar: <i>d) depoziton marrëveshjet origjinale ndërkombëtare, sipas legjislacionit në fuqi që rregullon</i>

				<i>marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë.</i>
	Ndërhyrje me <i>track changes</i> në tekstin e projektligjit: Të shtohet një pikë e re, “e”: “e) ushtron mbrojtjen diplomatike në formën dhe kufijtë e lejuar nga e drejta ndërkombëtare.”	Suela J.	Pranuar	Në nenin 15, pika 2 të shtohet shkronja “ë”: “ë) ushtron mbrojtjen diplomatike në formën dhe kufijtë e lejuar nga e drejta ndërkombëtare.”
Neni 18 “Sekretari i Përgjithshëm”	Në Nenin 18, pika 4, grada e Sekretarit të Përgjithshëm (SP) të jetë Ambasador ose Ministër Fuqplotë, pasi ai është nëpunësi më i lartë civil dhe i karrierës diplomatike në institucion; veç kësaj, në diplomacinë shqiptare tanimë ka një kontigjent të mirë me gradën diplomatike Ministër Fuqplotë.	KASH	Refuzuar	Propozimi kufizon ekstremisht mundësinë e përzgjedhjes, sepse nuk është në korrelacion me realitetin e gradave. Kategoria e propozuar është shumë e vogël, duke marrë parasysh kohëzgjatjen për të marrë gradën ambasador. P.sh. aktualisht vetëm dy individë kanë gradën ambasador, që të dy kanë dalë në pension.
	Pika 5- Sugjeroj mospërfshirjen e kësaj klauzole, pasi jep perceptimin e diskriminimit. Nese cdo anetar i sherbimit te jashtem arrin te plotesoje kriterin themelor per kandidim qe eshte pasja e grades diplomatike Minister Keshilltar, shtimi i kriterëve te perzgjedhjes mbi bazen e arsimit e ben me te forte perceptimin e subjektivizmit ne perzgjedhjen e kandidatures. Duke qene se ne piken 1 percaktohet se SP eshte nepunesi me i larte civil dhe i karrieres ne SHJ, ai eshte pasqyre e vete sherbimit, perfshire larmishmerine e bazes akademike. Duke qene se perzgjedhja behet nga ministri, nese ne momente te caktuara vleresohet si e nevojshme kjo cillesi e kandidatit, mund te behet kjo perzgjedhje, pa qenë e nevojshme të legjitimohet në projekt-akt.	Suela J	Pranuar	

	Neni 18, pika 5 , të hiqet. Preferencat profesionale për përzgjedhje nuk kanë vend në përmbajtjen e një ligji; nëse shihet e arsyeshme, mund të caktohen në akte nënligjore nëse vërtetë shihet e nevojshme.	Ejona H.	pranuar	
Neni 19 “Struktura e Ministrisë”	Pika 3- Ndërhyrje me <i>track changes</i> në tekstin e projektligjit: Fjala “ngre” të zëvendësohet me “ndërton”.	Suela J.	Pranuar	Riformuluar: 3. Ministria ndërton dhe mirëmban një sistem ... ky parashikim ligjor është hequr pas sugjerimeve të ministrive të linjës
Neni 20 “Protokolli i Shtetit”	Neni 20, që merret më trajtimin protokollar, duhet të përfshijë dhe drejtuesit e forcave politike, që janë parti parlamentare.	KASH	Refuzuar	Propozimi ose është i paqartë, ose nuk ka lidhje me përmbajtjen e dispozitës. Dispozita përcakton detyrat specifike të kësaj zyre, por nuk përcakton procedurat e ceremonialit shtetëror. Protokolli shtetëror nuk ka lidhje dhe nuk mund të bashkërendojë protokollin partiakë, pasi shërbimi i jashtëm është I depolitizuar dhe i shërben institucioneve kushtetuese. Marrëdhëniet me jashtë të partive politike nuk janë çështje e shtetit, janë çështje e partive politike.
Neni 21 “Akademia Diplomatike”	Duhet bere harmonizim i gjuhes së këtij neni me nenin 14 te projekti i cili percakton se Sherbimi i Jashtem perbehet nga Ministria..... Nese AD do te jete pjese e sherbimit te jashtem te perfshihet specifikisht ne nenin 14. Nese do te jete organ varesie i Ministrise, te behet zevendesimi sipas propozimit.	Suela J.	Pranuar pjesërisht	Mund të bëhet riformulimi i pikës 1 të këtij neni sipas propozimit: “Akademia Diplomatike është qëndër e zhvillimit të karrierës diplomatike, në

	Ndërhyrje me <i>track changes</i> në tekstin e projektligjit: Togfjalëshi “Shërbimit të Jashtëm” të zëvendësohet me “Ministrisë”. Persa i përket përmbajtjes, sugjerohet lehtësimi i tekstit nga përshkrimi i detyrave të AD, pasi këto do të rregullohen me akt nënligjore. Për më tepër duhet të krijohet një balancë e drejtë rregullatore dhe me institucione të tjera të varësisë, sikurse është Agjencia Kombëtare e Diasporës.			vijim referuar si “AD”. Pjesa tjetër e dispozitës përmban qëllimin, rrethin e detyrave prioritare, rrethin e detyrave plotësuese, statusin ligjor dhe autorizimin e nevojshëm për nxjerrjen e rregullave për organizimin, funksionimin dhe financimin e Akademisë Diplomatike. Këto dispozita janë lehtësuar
	Neni 21, pika 2, me paragrafin e fundit nënkupton që Akademia Diplomatike do të jetë e hapur për çdo individ??	Marsida K.	Sqaruar	Sugjerohet që Akademia Diplomatike të jetë e hapur për studiues të jashtëm. Kjo i shërben sidomos mbajtjes në eficiencë të kapaciteteve akademike. Por kjo nuk nënkupton, se pranimi në akademi është ipso lege. Rregullat e brendshme duhet të përcaktojnë kushte dhe kritere selektive për aplikimet, të cilat në varësi nga situata mund të jene shumë selektive, ose pak selektive, mund të lidhen me tuition fee të larta, deri në ekskluzive, ose mund të shoqërohen me bursa studimi, ose me mekanizma të tjerë promovues.
Neni 22 “Komisioni i Karrierës Diplomatike	Neni 22, pika 1 (b) të saktësojë që KKDD jep masat disiplinore për diplomatët (duke qenë se koncepti i	Ejona H.	Pranuar	Në reflektim të sugjerimit, pika 1 e nenit 22 mund të riformulohet si

dhe Disiplinës”	Shërbimit të jashtëm është më i gjerë – neni 39). Po në ligjin për nëpunësin civil, komisioni disiplinor propozon marrjen e masën disiplinore? A është e drejtë që tagrin e dhënies së masës disiplinore ta ketë një organ jokolegjial? Si veprohet nëse KKDD dhe Ministri nuk kanë të njëjtin qëndrim?			vijon: “1. Komisioni i Karrierës Diplomatike dhe Disiplinës i propozon Ministrit: a) gradat diplomatike për diplomatët, sipas përcaktimeve të këtij ligji dhe të Rregullores së Shërbimit të Jashtëm; b) dhënien e masave disiplinore për <i>diplomatët për kryerjen e shkeljeve të rënda ose shume të rënda</i>” Shqyrtimi kolegjial i masave për promovimin dhe disiplinën e diplomatëve është garanci ligjore për ta dhe instrument drejtësie administrative, por KKDD nuk mund të ketë vendimmarrje përfundimtare, përdryshe kjo denatyrton rolin dhe shtrembëron hierarkinë e strukturave që angazhohen në këtë procedurë. Sikurse është shpjeguar në një pikë tjetër të këtyre komenteve, vendimmarrja i takon titullarit dhe nuk mund të tjetërsohet. KKDD është strukturë ndihmëse, e cila ngrihet për të analizuar më mire çështjen. Raporti i
-------------------------------	---	--	--	---

				KKDD, me propozimin përkatës i përcillet ministrit nga sekretari i përgjithshëm, si çdo praktikë tjetër administrative, por sekretari i përgjithshëm nuk ka asnjë pushtet mbi përmbajtjen e këtij raporti, nuk mund ta kthejë atë mbrapsht, nuk mund ta modifikojë dhe nuk mund ta zëvendësojë me një raport tjetër. Sekretari i përgjithshëm mund të formulojë “dissenting opinion”, nëse konstaton se janë kryer shkelje të ligjit përgjatë procedurës. Gjykimin përfundimtar e ka ministri, sepse është ai që e vesh procedurën me vullnetin e institucionit. Kështu siç është formatuar, procedura është ligjërish korrekte dhe në harmoni me mënyrën e funksionimit të të gjitha institucioneve kur kryejnë procedura të kësaj natyre.
	Neni 22, pika 2 të riformulohet në përputhje me teknikën legjislative, nuk ka saktësi gjuhësore dhe qartësi në kuptim. (ngrihet me urdhër të ministrit dhe emërohet nga ministri në të njëjtën fjali?)	Ejona H.	Pranuar	Në reflektim të sugjerimit, pika 2 e këtij neni mund të riformulohet: “2. KKDD ngrihet me urdhër të Ministrit në muajin janar të çdo viti kalendarik dhe përbëhet nga pesë

				anëtarë, nga të cilët katër janë diplomatë karriere me gradë personale diplomatike të lartë dhe drejtori i burimeve njerëzore.
	Në Nenin 22, pika 2, Komisioni i Karrierës duhet të ngrihet nga SP, si nëpunësi më i lartë civil dhe i karrierës diplomatike, dhe vendimet e këtij Komisioni të jenë të detyrueshme për miratim nga Ministri.	KASH	Refuzuar	Propozimi nuk qëndron për arsyet që janë shtjelluar në disa pika më sipër.
	Neni 22, në pikat 2 dhe 3 ka një paqartësi të numrit të anëtarëve të KKDD, ku në pikën 2 thuhet se përbëhet nga 5 anëtare, dhe në pikën 3 thuhet se në përbërjen e tij janë drejtori i DBNJ (1 person) dhe 3 diplomatë karriere (3 persona) me gradën diplomatike personale të lartë, dhe të përcaktohet drejt nga fillon grada e lartë.	Marsida K.	Pranuar pjesërisht	Në reflektim të vërejtjes së mësipërme, pikat 2, 3 dhe 4 riformulohen si më poshtë: 2. KKDD ngrihet me urdhër të Ministrit në muajin janar të çdo viti kalendarik dhe përbëhet nga pesë anëtarë, nga të cilët katër janë diplomatë karriere me gradë personale diplomatike të lartë dhe drejtori i burimeve njerëzore. 3. KKDD drejtohet nga diplomati me gradën diplomatike personale më të lartë. Nëse në KKDD bëjnë pjesë më shumë se një diplomat me gradën më të lartë të njëjtë, Komisioni drejtohet nga diplomati që e gëzon këtë gradë më gjatë se të tjerët. Në rastet kur kohëzgjatja në

				gradë është e njëjtë, komisioni drejtohet nga diplomati me gjininë më pak të përfaqësuar. 4. KKDD mbledhet: a) për aplikimet për gradat diplomatike personale në muajin mars të çdo viti, b) për shqyrtimin masave disiplinore për shkeljet e rënda dhe shumë të rënda, rast pas rasti. 5. KKDD ushtron veprimtarinë deri në zëvendësimin nga KKDD pasardhës. 6. Mënyra e funksionimit të KKDD përcaktohet në Rregulloren e Shërbimit të Jashtëm. Paqartësia është adresuar.
	Neni 22, pika 3 parashikon se KKDD drejtohet nga diplomati me gradën diplomatike personale më të lartë. Është e paqartë si do të përzgjidhet kryesuesi i këtij Komisioni, në rast se ka gradën më të lartë e kanë disa diplomatë (karriere besoj?).	Ejona H.		Vërejtja adresohet me modifikimet e pikës 2 dhe pikës 3, si më sipër.
	Pika 3- Ndryshimi në këtë projekt qëndron në riformatimin e përbërjes së Komisionit. Zakonisht komisionet perbehen nga numer tek anetaresh per te mundesuar vendimmarrjen ne rast te votes, ky komision propozohet te perbehet nga 4 anetare -DBrNj dhe 3 diplomate. SP nuk do te jete me pjese e	Suela J.	pranuar	Vërejtja adresohet me modifikimet e pikës 2 dhe të pikës 3, si më sipër dhe i jepet përgjigje në komentet pararendëse.

	ketij Komisioni? Po ashtu mund te kete rast qe dy anetare te kenë gradë të njëjtë të lartë, duhet parashikuar ky rast në Rregullore, për përcaktimin e drejtimit të Komisionit.			
	Neni 22, pika 4 (a) sugjeroj që KKDD të ngrihet një herë dhe të mblidhet sa herë plotësohen kushtet ligjore për funksionimin e tij. Sugjeroj të riformulohet si vijon: <i>“a) për aplikimet për gradat diplomatike personale kur plotësohen afatet ligjore për përfitimin e tyre.”</i> Kështu shmangen situatat e krijuara nga praktika e deritanishme kur komisioni mblidhet njëherë në vit, duke djegur afatin për marrjen e gradave diplomatike personale. Gjithashtu, me këtë formulim, nuk ka nevojë të mblidhet jashtë radhe për kategorinë e gradave, të përcaktuara në pikën 6 të po këtij neni.	Ejona H.	Pranuar pjesërisht	Komisioni ngrihet në muajin janar të çdo viti me urdhër të ministrit dhe mblidhet a) për aplikimet për gradat diplomatike personale në muajin mars të çdo viti, b) për shqyrtimin masave disiplinore për shkeljet e rënda dhe shumë të rënda, rast pas rasti. Nuk mund te mblidhet sa here plotësohen afatet per secilin diplomat. Pranohet që të mos mblidhet jashtë radhe por vetëm në periudhat e përcaktuara.
	Neni 22, pika 4/a, KKDD për aplikimet për gradat diplomatike personale <i>mblidhet në muajt mars dhe shtator</i>, në kushtet ku afatet e marrjes së gradave për diplomatët janë të ndryshme, të shtohet një paragraf në nenin 50, që afati i marrjes së gradave përllogaritet nga momenti që diplomati i karrierës plotëson afatin, ose për ndryshe komisioni i ngritur në muajin janar të shqyrtoj rast pas rasti çdo kërkesë për gradë.	Marsida K.	Refuzuar	Ky sugjerim duhet të shihet në përputhje me trajtimin e sugjerimit sipër tij. Parimisht duhet bërë konstatimi, se në përgjithësi perceptimi i komentuesve është që dhënia e gradave duhet të lidhet vetëm me afatin ligjor të përfitimit të tyre. Në fakt sistemi i karrierës është një sistem, i cili duhet të ketë në epiqendër vlerësimin e performancës. Gradat më të larta duhet të jepen

				sipas nevojës institucionale dhe sipas rezultateve personale në karrierë. Dhënia e gradës nuk duhet të jetë proces automatik. Propozimi nuk qendron.
	Neni 22, pika 4 (b) ka nevojë të rishikohet pjesa “Disiplinore” e KKDD: a është në frymën e ligjit të nëpunësit civil i cili parashikon ngritjen e komisionit rast pas rasti? A do marrë pjesë eprori direkt i një diplomati karriere në Komision siç parashikon ligji për nëpunësin civil? Nëse po, Komisioni do përbëhet nga 6 veta – numër çift? A ka vërtetë nevojë që komisioni disiplinor të jetë standing? Problematikat që kanë çuar, fjala vjen, në procese të humbura gjyqësore me këtë objekt për institucionin, kanë lindur si pasojë e faktit që Komisioni Disiplinor nuk ka qenë <i>standing</i>? Saktësim: komisioni i disiplinës shqyrton shkeljet e rënda dhe shumë të rënda.	Ejona H.	pranuar	Pyetjet që shtrohen përbëjnë lëndë diskutimi për formulimet në Rregulloren e re të Karrierës dhe Disiplinës, sepse mënyra e funksionimit të Komisionit të Karrierës Diplomatike dhe Disiplinës është përcaktuar që të rregullohet prej saj. Aty mund të përcaktohet edhe roli i eprorit të drejtpërdrejtë në shqyrtimin e masave disiplinore, i cili jo domosdoshmërisht duhet të jetë anëtar në komision. Në pikën 5 të këtij neni është parashikuar se Komisioni ushtron veprimtarinë deri në zëvendësimin nga komisioni pasardhës. Komisioni ka një natyrë specifike, e cila buron nga statusi i dyfishtë i diplomatëve të karrierës, si nëpunës civilë dhe si pjesë e shërbimit diplomatik. Në reflektim të

				saktësimi, mund të riformulohet shkronja “b” e pikës 4, si vijon: “b) për shqyrtimin masave disiplinore për shkeljet e rënda dhe shumë të rënda, rast pas rasti.” Vërejtjet dhe pyetjet janë adresuar me ndryshimet përkatëse.
	Pika 6- Kjo është një dispozitë konfuze dhe lejon përjashtimin nga rregulli në mënyrë të pajustificuar. Perderisa komisioni mbledhet 2 herë në vit dhe në mënyrë të rregull duhet t’i ezarojë të gjitha kërkesat për gradë, pse është e nevojshme të mbledhet ad hoc? Nëse një diplomat nuk ka gradën që kërkohej për një post dhe nuk plotëson kriterin e gradës për emerim në përfaqësi diplomatike, ai duhet të presë kohën deri sa ta plotësojë këtë kriter dhe të marrë gradën në mbledhjen e radhës.	Suela J.	Pranuar	Edhe ky koment është i lidhur me perceptimin që e lidh marrjen e gradës me afatin ligjor dhe jo me nevojën institucionale. Vërejtja është adresuar me ndryshimet përkatëse.
	Neni 22, pika 6, është e paqartë nëse bëhet fjalë për gradë personale, apo gradë emërimi.	Marsida K.	Refuzuar	KKDD propozon dhënien e gradave diplomatike personale. Paqartësia është adresuar me ndryshimet përkatëse.
	Neni 22, pika 7 të riformulohet: “Procedurat e hollësishme për zbatimin e këtij neni përcaktohen në Rregulloren e Shërbimit të Jashtëm”; “mënyra e funksionimit” nuk përfshin psh. si përzgjidhet kryesuesi i këtij Komisioni, në rast se gradën më të lartë e kanë disa diplomatë.	Ejona H.	Pranuar pjesërisht	Riformulimi nuk është i domosdoshëm pasi mënyra e funksionimit përfshin dhe procedurën. Nga ana tjetër, shembulli i zgjedhur në mbështetje të komentit nuk ka lidhje me lëndën. Gjithësesi riformulimet në nenin 22 e zgjidhin çështjen.

				Vërejtjet janë adresuar.
Neni 23 “Komisioni i Apelimit”	Ndër elementët pozitive të draftit të ri janë: 2. Neni 23, parashikimi i ngritjes së Komisionit të Apelimit është risi pozitive. Por ka një disproporcion që duhet trajtuar në trajtimin e të dy organizmave, ndërsa përbërja e KKDD përcaktohet në ligj, përbërja e KA, që në thelb duhet të jetë një instrument vlerësimi i të parit, nuk mund t’i lihet një akti nënligjor.	Suela J.	Pranuar	Komenti është racional. Prandaj është menduar riformulohet duke parashikuar një përbërje me tre anëtarë për komisionin e apelimit. Në këtë rast neni 23 është riformuluar si më poshtë: 1. Komisioni i Apelimit, në vijim referuar si “KA” ka për detyrë shqyrtimin e ankesave ndaj vendimeve të KKDD. 2. KA ngrihet me urdhër të Ministrit në të njëjtën kohë me KKDD dhe përbëhet nga tre anëtarë, që janë Sekretari i Përgjithshëm dhe dy diplomatë karriere me gradë personale diplomatike të lartë, me kushtin të mos jenë anëtarë të KKDD. 3. KA drejtohet nga Sekretari i Përgjithshëm dhe ushtron veprimtarinë deri në zëvendësimin nga KA pasardhëse. 4. Mënyra e funksionimit të KA përcaktohet në Rregulloren e Shërbimit të Jashtëm.
	Neni 23 krijon një mekanizëm të ri që është Komisioni i Apelimit (KA), që mendohet duhet të përcaktohen qartë në	Ejona H.	Pranuar pjesërisht.	Vërejtja merr zgjidhje nëse pranohen

	ligj përbërja, mënyra e funksionimit dhe kompetencat që i janë lënë një akti nënligjor. Ky Komision duket se ka epërsi mbi KKDD, që përbërja, mënyra e funksionimit dhe kompetencat e të cilit janë përcaktuar në ligj. Nga mungesa e këtyre përcaktimeve në ligj është e paqartë edhe vlera e këtij mekanizmi që shqyrton ankesat ndaj “vendimeve” të cilat në fakt janë propozime të KKDD? Vendimet, qartësisht, i merr Ministri, ndërkohë KA nuk ka tagër të shqyrtojë vendimet e tij. A është vërtetë i nevojshëm KA? A duhet të perceptohet si organ epror i KKDD brenda aparatit të MEPJ? Nëse po, pse përbërja referohet në ligj për KKDD ndërsa për organin e tij epror i lihet një akti nënligjor? A duhet të jenë anëtarët e KA me eksperiencë dhe dije më të lartë se anëtarët e KKDD? Ku gjehen këta anëtarë nëse ata më me eksperiencë janë anëtarë në KKDD?			formulimet në pikën më sipër. Sa i përket shqetësimeve mund të thuhet se mekanizmi i komisionit të apelit është një garanci shtesë për subjektet që i nënshtrohen procedurës në KKDD, për t’u dëgjuar dhe për të shprehur në rrugë administrative shqetësimet e tyre. Sistemet që funksionojnë me hallka të ankimit administrativ konsiderohen më të pëlqyeshme se sa sistemet me mundësi ankimi vetëm në gjykatë. As KKDD as komisioni i apelit nuk janë organe, aq më tepër të vendosura në marrëdhënie hierakike. Ata janë mekanizma institucionale që shqyrtojnë dhe shprehen për çështje që futen në lëndën e tyre. Propozimi merr përgjigje sipas formulimit në pikën pararendëse.
	Edhe Komisioni i Apelit, i parashikuar në Nenin 23, duhet të ngrihet më urdhër të SP dhe jo të Ministrisë.	KASH	Refuzuar	Sugjerimi nuk qëndron për arsyet që janë shtjelluar në disa pika më sipër.
Neni 24 “Misioni diplomatik” Neni 25 “Posti konsullor”	Nenet 24 dhe 25 duhet të jenë të përmbledhur, se Misionet Diplomatike dhe Konsullore janë pjesë e MEPJ-së dhe drejtohen prej kësaj të fundit.	KASH	Refuzuar	Racionali i këtij sugjerimi nuk është i qartë. Misionet Diplomatike dhe Postet Konsullore janë specifika të

				ndryshme bazuar dhe në konventa e 1961 dhe 1963.
Neni 32 “Kreu i misionit diplomatik”	Ndër elementët pozitive të draftit të ri janë: 3. Neni 32-Kreu i Misionit Diplomatik-rivendosja e mandatit katër vjeçar dhe kufizimi i mandateve të shumëfishta. Pika 4- Ndryshimi i sekuences se procedures, e kthen rolin e KPJ teresisht jofunksional, pasi ne cdo rast nuk ndikon ne proceduren e emerimit te kandidatit per ambasador.	Suela J.	Pranuar	
	Pika 4, Komisioni i Politikës së Jashtme të Kuvendit duhet të japë gjykim mbi kandidatin për Ambasador, kur ai paraqet platformën e tij të punës gjatë mandatit të tij, ashtu siç ka qënë e parashikuar më parë, përfshi Ligjin e vitit 2015. Mendimi i këtij Komisioni duhet t’i përcillet Presidentit të Republikës, përpara dekretimit të Ambasadorit në fjalë.	KASH	Pranuar	
	Neni 32, pika 6. Si zbatohet parashikimi për mandatin 4 vjeçar të krerëve të misioneve diplomatike dhe posteve konsullore? Po në rastin që këto nene, të cilët nuk parashikojnë mekanizma për zbatim, nuk zbatohet dhe kreu qëndron në detyrë për 8 vjet, a ka të drejtë të emërohet për një mandat të dytë?	Ejona H.	Sqaruar	Pyetjet janë të një natyre hipotetike. Rregullat vendosen për t’i zbatuar. Mjetet mbrojtëse ndaj moszbatimit nuk përcaktohen për çdo dispozitë. Ato kanë karakter të përgjithshëm dhe lidhen me subjektin që shkel ligjin, me natyrën e shkeljes, më subjektin që preket nga shkelja, me llojin e dëmit të shkaktuar etj. Përgjegjësia ne këtë rast është e kreut te shtetit qe dekreton dhe liron nga detyra dhe MEPJ qe bën propozimin. Kreu i misionit nuk mund të ushtrojë më shumë se dy mandate të

				njëpasnjëshme ne misione diplomatike dhe poste konsullore, që nënkupton se nuk mund të ketë mandat më të gjatë se 8 vjet. Për të qartësuar edhe më shumë përfundimin e mandatit të kreut të misionit diplomatik dhe postit konsullor është vendosur pika 7 e formuluar si më poshtë: Pas përfundimit të mandatit të ambasadorit, diplomatit i karrierës që ka mbajtur këtë postpunon në Ministri për një periudhë kohe prej jo më pak se gjysma e kohës që ka qendruar në krye të misionit diplomatik.
	Neni 32, pika 6, është e paqartë nëse Kreu i Misionit Diplomatik, vijon një mandat 8 vjeçar në tjetrin vend, apo bën dy mandate me nga 4 vjet në vende të ndryshme. Në përfundim të afatit, lirohet nga Presidenti me përmbushjen e kohës???	Marsida K.	Sqaruar	Kjo pikë e sqaruar edhe në përgjigjen e komentit më sipër. Mandati në një mision diplomatik është 4 vjet, por diplomati mund të emërohet menjëherë në një mision tjetër diplomatik. Një emërm të tretë të menjëhershëm në mision diplomatik nuk mund të ketë. Diplomati duhet të kthehet në atdhe dhe të ushtrojë detyrat që i caktohen në ministri, ose në institucionet e tjera të administratës

				qendrore. Procedura përcaktohet në pikën 6 të nenit 35 Kreu i Misionit Diplomatik si dhe në pikën 3 dhe 4 të nenit 49 (Ministri urdhëron transferimin dhe emërimin e diplomatit të karrierës në një pozicion tjetër në Shërbimin e Jashtëm, tre muaj para datës së transferimit. Procedurat e emërimit dhe mbarimit të detyrës në misionet diplomatike ose postet konsullore përcaktohen në Rregulloren e Shërbimit të Jashtëm.) Kompetenca për transferimin, lëvizjen paralele dhe ngritjen në detyrë i takon ministrit (neni 45).
	Formulimi i Nenit 32 “Kreu i misionit diplomatik”, Pika 6, duket i paqartë. 1. A kemi të bëjmë me mandatin ku kreu i misionit diplomatik kryhen 8 vjet shërbim të jashtëm, për shembull në SHBA, dhe pastaj nuk ka më të drejtë të shërbejë në përfaqësitë tona për gjithë jetën? 2. A kemi të bëjmë me mandatin ku kreu i misionit diplomatik kryen 8 vjet shërbim të jashtëm, për shembull në SHBA, dhe pastaj shërben 8 vjet në Gjermani dhe më pas mund të rikthehet për të shërbyer sërish për 8 vjet në SHBA? 3. A kemi të bëjmë me mandatin ku kreu i misionit diplomatik kryen 8 vjet shërbim të jashtëm, për shembull në SHBA dhe, pas këtij shërbimi ai nuk ka më të drejtë për të gjithë jetën të shërbejë në SHBA, por mund shërbejë	Alban K.	Sqaruar	Pyetjet janë sqaruar në komentin më sipër. Propozimi për zgjatje afati në rrethana specifike është shqyrtuar dhe refuzuar nga grupi i punës sipas praktikës edhe të vendeve të tjera të Bashkimit European.

	në përfaqësitë tona në vendet e tjera të botës? 4. Çfarë ndodh në rastet kur kreu i misionit diplomatik kryen vetëm një mandat 4 vjeçar, për shembull në SHBA? Në varësi të përgjigjeve për tri pyetjet e para, a nuk ka nevojë të qartësohet edhe ky mandat? Duke qenë se formulimi aktual i pikës 6, të nenit 32, lë, së paku, 3 pikëpyetje, do ishte e udhës që ky nen të qartësohej më në detaje për të mos lënë shteg për interpretime. Gjithashtu, do sugjeroja që në përfundim të mandatit 8 vjeçar, të ishte një klauzolë e veçantë që, për raste specifike, kur në shtetin pritës ka zhvillime të atilla politike që përkojnë me mbarimin e mandatit të ambasadorit, por që këto zhvillime ambasadori aktual si njohës shumë i mirë i gjendjes politike në atë shtet, nuk është mirë të ndryshohet në atë moment, këtij ambasadori t'i shtyhet mandati, por jo më shumë se sa 6 muaj deri 1 vit, me të njëjtën procedurë siç ndiqet emërimi i tij në kushte normale, me përjashtim të pikës 4 të po këtij neni.			
	Pika 6, mandati duhet të jetë deri në 4 vite	KASH	Refuzuar	Sugjerimi nuk është shoqëruar me shpjegim. Nuk kuptohet pse duhet të jetë kështu.
	Pika 7, i Ngarkuari me Punë duhet të emërohet nga Kryeministri, me propozim të Ministrit të Jashtëm, mbasi i Ngarkuari me Punë është Titullar i MISIONIT dhe ky nivel përfaqësimi mund të jetë për arsye politike në vendin pritës, afatgjatë, etj.	KASH	Pranuar	Propozim qëndron
	Në Pikën 8, në çdo rast, përcaktimi i drejtuesit të Misionit të bëhet me miratim të Ministrit, mbasi diplomati në atë detyrë bëhet Titullar i Misionit. Kjo të shprehet në mënyrë eksplicite në ligj.	KASH	Refuzuar	Formulimi krijon fleksibilitet në varësi të kushteve të vakances që krijohet. Ka vakanca të përkohshme brenda mandatit të ambasadorit ka dhe vakanca që krijohet pas lënies së mandatit të ambasadorit deri në marrjen e

				mandatit nga ambasadori i ri.
Neni 33 “Përzgjedhja e kreut të misionit diplomatik”	Ky nen se bashku me nenin 37 perbejne thelbin substancial te profilit te ardhshem te sherbimit te jashtem. Zgjedhja ndermjet dy modeleve qe njeh pervoja nderkombetare, nje sistemi te mbyllur apo nje sistemi te hapur diplomatik eshte nje vendim politik, por qe duhet te respektojë disa parime sic jane ajo e merites dhe e vazhdimësisë se karrieres, te njohura edhe ne kete projekt ne nenin 4. Perjashtimet nga rregulli duhet te jene te percaktuara qarte dhe te mos i lene vend subjektivizmit. Ne propozimin konkret kriteret perforcuese jane minimaliste, vetem ato te percaktuara per pranimin ne sherbimin e jashtem. Ky mund te jete nje kriter i pranueshem per eksperte, por jo per nivel ambasadori. Rregullimi i kesaj situate mund të behet duke ju referuar praktikave te mepareshme, ose te vendoset nje perqindje fikse per kete grup emerimesh, ose te perfshihen kriteret shtese te ngjashme me ligjin aktual. Lidhur me piken 4 të nenit, lidhja e nje kontrate ndermjet Ministrise dhe nje ambasadori te emeruar me dekret te Presidentit te Republikes eshte e pavlere. Te drejtat dhe detyrimet e e ambasadorit te emeruar percaktohen ne ligjin per sherbimin me jashte dhe nje kontrate nuk mund te shtojë ose te pakesojë keto te drejta dhe detyrime.	Suela J.	Pranuar pjesërisht	Çështja e kuotës është trajtuar në kuadër të komenteve parimore më lart, përfshirë edhe shpjegimet për nevojën e bashkëzistencës së dy vektorëve. Të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga kuadri ligjor i nëpunësit civil dhe nga ai i diplomatit të karrierës përveç sa referuar në projektligj, do përcaktohen në Rregulloren e Shërbimit të Jashtëm.
	Pika 1, kreu i Misionit duhet të përzgjidhet nga ata diplomatë që mbajnë gradën diplomatike Ministër Fuqiplotë dhe Ambasador	KASH	Refuzuar	Kjo është çështje zgjedhjeje. Pas saj nuk ka arsyetim juridik. Propozimi nuk qëndron.
	Pika 2 duhet vënë tavanin deri në 15%.	KASH	Refuzuar	Çështja e kuotave është sqaruar në diskutimin parimor. Propozimi nuk qëndron.
Neni 36 “Kreu i postit konsullor”	Neni 36 duhet të parashikojë detyrimin për përgjegjësitë direkte me natyrë financiare dhe administrative për kreun e postit konsullor njësoj si në rastin e kreut të misionit diplomatik.	Ejona H.	Pranuar dhe sqaruar.	Homologimi i formulimeve për pjesën administrative dhe financiare është racional. Sa

	Neni 36, pika 6. Si zbatohet parashikimi për mandatin 4 vjeçar të krerëve të misioneve diplomatike dhe posteve konsullore? Po në rastin që këto nene, të cilët nuk parashikojnë mekanizma për zbatim, nuk zbatohet dhe kreu qëndron në detyrë për 8 vjet, a ka të drejtë të emërohet për një mandat të dytë?			i takon komentit për pikën 5 të nenit 36, sqarimi është i njëjtë me sqarimin për pikën 6 të nenit 32, të ezauruar në komentet më sipër.
Neni 37 “Personeli i misioneve diplomatike dhe posteve konsullore”	Në këto rrethana po mjaftohem të përsëris një nga sugjerimet kryesore të dhëna nga ana ime në qershor të vitit 2014, kur diplomatët ishin ftuar të jepnin mendime për ligjin në fuqi. Ashtu si dhjetë vite më parë, edhe aktualisht gjykoj se është e nevojshme që të përcaktohen periudhat e përafërta të shërbimit të çdo diplomati në MPJ dhe në përfaqësitë diplomatike. Jo më kot kuadri ligjor-administrativ dhe praktika e shërbimeve të jashtme britanike, amerikane, holandeze dhe të një sërë vendeve të tjera sigurojnë raportin rreth 2/3 e karrierës së diplomatëve jashtë shtetit dhe rreth 1/3 në kryeqytetin përkatës. Nëse edhe vendi ynë do të ndiqte praktikën më të mira, çdo diplomati shqiptar me karrierë 40-vjeçare do t'i takonte të punonte rreth 14 vite në ministri dhe të shërbente rreth 26 vite në misionet tona diplomatike jashtë shtetit. Për fat të keq, praktika e tridhjetë viteve të fundit të shërbimit të jashtëm shqiptar tregon se shumë nga kolegët tanë preferojnë të qëndrojnë mbi 90 % të karrierës së tyre jashtë shtetit, kryesisht në vendet e Bashkimit Evropian dhe SHBA. Nga ana tjetër, ka edhe kolegë - më të paktë në numër në krahasim me ata të grupit të parë - të cilët preferojnë të qëndrojnë mbi 90 % të karrierës së tyre në Tiranë. Edhe po të zbatohesh me rigorozitet projektligji që po diskutohet, shumë diplomatë, pasi të punonin tetë vite në përfaqësi, do ta gjenin mënyrën për të qëndruar fare pak në Shqipëri me synimin që të kalonin pothuajse të gjithë karrierën e tyre jashtë shtetit. Sigurisht që do të ishte në të mirën e shërbimit tonë të jashtëm që të shmangeshin deformime të tilla.	Genti B.	Pranuar	Kufizimi me jo më shumë se dy mandate të njëpasnjëshme në mision diplomatik që vendoset nga projektligji realizon saktësisht këtë qëllim. Gjithashtu, pika 6 e nenit 35 e aderson këtë shqetësim duke u shprehur se “Kreu i Misionit Diplomatik i cili është diplomat karriere, pas përfundimit të mandatit apo mandateve të njëpasnjëshme punon pranë ministrisë për një periudhë prej jo më pak se gjysma e mandatit/kohëzgjatjes që ka shërbyer jashtë vendit.”
	Nga pikëpamja e disiplinës, a mund t'i bëjë MEPJ procedim disiplinor nëpunësit të një institucioni tjetër?	Ejona H.	Sqaruar	Neni 37 bën fjalë për personelin e misioneve

				diplomatike dhe posteve konsullore. Pavarësisht se nga vijnë, të gjithë ata janë emërtesë e ministrisë. Personeli që vjen nga institucionet e tjera, emërohet nga ministri përgjegjës për punët e jashtme, sipas marrëveshjes ndërdikasteriale, ndërkohë që fondi i pagave përballohet nga institucioni dërgues. Personi i emëruar në misionin diplomatik ka varësi të dyfishtë. Kjo duhet përforcuar në Urdhrin e përbashkët ndërmjet të dy institucioneve.
	Pika 1 duhet të përcaktohet si diplomat karriere dhe jo thjesht diplomat; sipas këtij Projekt-ligji ky term merr karakter abuziv dhe subjektiv	KASH	Refuzuar	Në misionin diplomatik mund të bëjnë pjesë diplomatë karriere dhe diplomatë që vijnë nga jashtë sistemit, si dhe personel teknik dhe shërbimi. Termi diplomat sipas përkufizimit të dhënë përfshin si diplomatët e karrierës edhe ata nga jashtë sistemit diplomatik të përfshirë në misionet diplomatike. Propozimi nuk qëndron.
	Neni 37, pika 2. Pse duhet të vendoset me VKM procedura për emërimin e personelit të institucioneve të tjera? A nuk është ligji dhe marrëveshja administrative midis dy organeve bazë	Ejona H.	Pranuar	Ka një numër çështjesh procedurale që nuk rregullohen nga kjo dispozitë

	ligjore e mjaftueshme për të përcaktuar rregullat procedurale të emërimit? Për më tepër, që trajtimi financiar, në fjalinë pasardhëse, sqaron se ato përballohen nga institucioni dërgues.			dhe që nuk formojnë lëndë për rregullim me ligj. Si kumtohet vullneti i institucionit për të emëruar një nëpunës në mision diplomatik? a është i detyruar ministri të bëjë emërimin, apo mund të refuzojë? Nëse refuzon, si zgjidhet ngërçi? Si negociohet marrëveshja ndërinstitutionale ? Si bëhet kalimi i fondit të pagave? Këto janë disa nga çështjet që kërkojnë rregullimin me një akt tjetër dhe është marrë parasysh propozimi pjesërisht duke i dhënë zgjidhje të gjithë çështjeve të lartë përmendura nëpërmjet urdhrit të përbashkët të dy institucioneve.
	Neni 37, pika 3. Cila është garancia juridike që supozon hartuesi i ligjit se po merr me mbivendosjen e kontratës dhe urdhrit të emërimit? A nuk i nënshtrohet pikërisht këtij ligji dhe gjithë akteve të tjera nënligjore ky diplomat jo-karriere për aq kohë sa ushtron detyrën në Shërbimin e Jashtëm (referuar nenit 3, pika 2)? Për më tepër, parashikimi i bërë në këtë pikë është jo vetëm diskriminues, por cenon dhe parimin e sigurisë juridike për diplomatët e karrierës, të cilët edhe pas ndjekjes së procedurave të rekrutimit e testimeve për tu bërë nëpunës civilë e më pas pjesë e shërbimit të jashtëm, edhe pas 1 dekade eksperiencë në shërbimin e jashtëm, ende nuk e kanë marrë gradën diplomatike personale “Sekretar i parë”.	Ejona H.	Pranuar	Personeli i emëruar nga jashtë sistemit, sipas kësaj pike, nuk janë diplomatë në profesion, për teknikë nga fusha jo diplomatike, të cilët kur janë në mision përfitojnë statusin (privilegjet dhe imunitetet) e diplomatëve. Grada e referuar në këtë pikë tregon trajtimin që do i ofrohet këtij personeli. Personeli teknik nuk përfshihen në mision për të

				kryer detyra diplomatike, por për të kryer detyra teknike, kështu që është i pavend dyshimi se ata cënojnë të drejtat e diplomatëve të karrierës.
	Neni 37, pika 3, Si përcaktohen rastet e veçanta? A ka një vlerësim aktual të raportit të personave të emëruar nga radhët e diplomatëve të karrierës dhe rasteve të veçanta??	Marsida K.	Refuzuar	Rastet e veçanta përcaktohen nga nevojat e veçanta. Vlerësim paraprak për këtë gjë nuk mund të ketë. Ai është një proces që zhvillohet në kohë dhe në hapësirë. Krijon fleksibilitet për nevojat e ndryshme që i paraqiten SHJ psh njohuri të caktuara, njohja e gjuhës së vendit, pamundësia për emërim nga stafi i MEPJ etj. Një eksperience pozitive ka qene emërimi i një grupi ekselentesh në misione diplomatike në vitin 2019 të cilët u përzgjedhën nga një komision diplomatësh me grade të larte. Në një mision diplomatik të caktuar mund të lindë nevoja në një moment të caktuar p.sh. që të ngrihen dhe operohen sisteme të caktuara të sigurisë kibernetike. Nga këtu mund të lind nevoja për të dërguar në mision informacione që të operojnë këto sisteme. Ky

				mekanizëm ligjor e lejon këtë.
Pika 3	Në rastet kur kërkohen ekspertë të përkohshëm nga jashtë sistemit, duhet të mirëargumentohen si “rast tejet i veçantë” nga një grup pune i ngritur posaçërisht për këtë qëllim. Përzgjedhja e tyre duhet të bëhet me konkurs, me terma të mirë përcaktuar dhe për rekrutimin e tyre duhet të angazhohet Komisioni i Karrierës, i cili duhet të emërohet nga SP.	KASH	Refuzuar	Ky sugjerim kapërcen konceptin e projektligjit në të gjitha linjat e mendimit. Propozimi nuk qëndron.
	Ministrit i duhet kufizuar vendimmarja në përzgjedhjen e kandidatëve të ekspertëve, për të eliminuar çdo tendencë klientelizmi, partitizmi dhe dëmtim të karrierës.	KASH	Refuzuar	A është sekretari i përgjithshëm imun nga klientelizmi? A është i tillë KKDD? Klientelizmi luftohet me mjete politike dhe me masa ligjore. Autoriteti më i lartë dhe më i interesuar për implementimin e të dyjave është ministri. Ai është dhe garancia më e madhe.
Pika 4	Neni 4 është abuziv. Nuk ka pse dhe nuk mund të këtë 2 Ambasadorë në të njëjtin Mision Diplomatik, ndërkohë që grada "Ambasador" jepet më Dekret Presidenti, jo nga Ministri.	KASH	Refuzuar	Ka praktika në disa shtete kur në Misionin e Përhershëm pranë një organizate ndërkombëtare, personeli shtohet sikurse rasti i Republikës së Shqipërisë në Këshillin e Sigurimit në OKB. Emërtesa “Ambasador” lidhet me përgjegjësinë e shtuar në raport me pjesën tjetër të misionit por sigurisht nën Ambasadorin e akredituar. Pika 4 është riformuluar si më poshtë: Në raste të veçanta, në përbërje të misionit

				diplomatik pranë organizatave ndërkombëtare, përveç Ambasadorit të emëruar nga Presidenti i Republikës, Ministri mund të emërojë diplomatë me gradën “Ambasador”, të cilët ushtrojnë funksionet e zëvendës shefi të misionit, nën autoritetin e kreut të misionit diplomatik.
	Pika 4- Praktika e emerimit të me shume se nie ambasadori ne misionin diplomatik prane organizatave nderkombetare eshte mjaft e kufizuar. Konkretisht vetem BE, per shkak te organizimit te saj, pranon 3 ambasadore nga vendet anetare, ne Coreper 2, Coreper 1 dhe PSC. Autoriteti drejtues ne perfaqesi eshte Perfaqesuesi i Perhershëm, por 2 ambasadoret e tjere jane te pavarur ne fushat e tyre dhe kane perfaqesim te plote ne organizmat ku perfaqesojne vendin e tyre. Per kete arsye perzgjedhja e tyre eshte e rendesishme dhe nuk mund te barazohet me emerimin e nje diplomati te thjeshte. Pratika e disa vendeve tregon qe ata zgjidhen nga qeveria. Propozimi konkret eshte qe per kete kategori ambasadoresh me emerim, por jo me grade, te ndiqet e njejta procedure emerimi nga KM, si ne rastin e Konsujve te Pergjithshem. Ndërhyrje me <i>track changes</i> në tekstin e projektligjit: <u>“4. Në raste të veçanta, në përbërje të misionit diplomatik pranë organizatave ndërkombëtare mund të shërbejnë diplomatë me gradën “Ambasador”, të cilët ushtrojnë funksione të kufizuara përfaqësimi, nën autoritetin e kreut të misionit diplomatik. Ambasadori i përzgjedhur sipas kësaj pike, emërohet dhe lirohet me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e Ministrit. Përzgjedhja e Ambasadorit bëhet sipas të njëjtës procedurë me të cilën bëhet përzgjedhja e kreut të misionit diplomatik, nga radhët e diplomatëve të karrierës, me</u>	Suela J.	Refuzuar	Kjo vërejtje duhet të shihet së bashku me komentin më sipër.

	<u>gradë diplomatike personale jo më pak se “Këshilltar”.</u>			
	Neni 37, pika 5. Nuk ka mekanizma për zbatimin e këtij detyrimi. Megjithatë, ndryshe nga rasti i krerëve të misioneve dhe posteve, kjo mund të adresohet dhe në një akt nënligjor.	Ejona H.	Sqaruar	Detyrimin për zbatimin e kësaj dispozite e ka institucioni dhe drejtuesi i saj. Ai është mekanizmi zbatues më i drejtpërdrejtë, më i afërt, më i sigurtë dhe ligjërish më kompetent.
	Pas pikës 5 mund të shtohet: “Koha e qëndrimit të diplomatit të karrierës në ministri pas kthimit nga jashtë nuk duhet të jete më pak se dy vjet.”	Parid V.	Pranuar pjesërisht	Në përgjigje të këtij propozimi, është shtuar pika 6 në nenin 35 e formuluar si më poshtë: „Pas përfundimit të mandatit, diplomatit i karrierës i emëruar në misionin diplomatik apo postin konsullor, punon në Ministri për një periudhë kohe prej jo më pak se gjysmën e kohës që ka qëndruar në misionin diplomatik apo postin konsullor.“
	Neni 37, pika 6, nuk mendoj se qartëson pozitën e diplomatit (jo të karrierës) dhe të diplomatit të karrierës. Mendoj të rishikohet me vëmendje nga Grupi i Punës dhe të sqarohet trajtimi i secilit.	Ejona H.	Refuzuar	Dispozita rritet kushtin bazik për të punuar në shërbimin me jashtë, i cili është i njëjtë si për diplomatët e karrierës, ashtu edhe për personelin që vjen në shërbim nga jashtë sistemit të karrierës. Dispozita nuk merret me diplomatët e karrierës, por vetëm me personelin që vjen

				nga jashtë sistemit të karrierës.
Neni 38 “Privilegjet dhe Imunitetet”	Në këtë nen është shtuar pika 2, parashikim i ri ligjor. Kjo dispozite duhet parë me kujdes, pasi sipas praktikës ndërkombëtare shtetet janë të rezervuar në heqjen e imunitetit të përfaqësuesve të tyre diplomatike. Në rastet me të shpeshta kur diplomatët kryejnë shkelje në vendin pritës, në varesi dhe të shkeljes, shteti dërgues i rikthen në atdhe, por nuk i lejon të jenë subjekte të juridiksionit të shtetit pritës.	Suela J.	Refuzuar	Heqja e imunitetit sipas kësaj dispozite nuk është veprim automatik. Dispozita le mundësinë që gjyrimi të bëhet duke peshuar interesin shtetëror, mbarëvajtjen e marrëdhënieve me shtetin pritës dhe pasojat që mund të vijnë nga heqja e imunitetit
Neni 39 “Kategorizimi i personelit të Shërbimit të Jashtëm”	Neni 39 , duhet të përfshijë një pikë të re që të rendisë edhe “diplomatët e karrierës”, në kushtet kur kemi një përkufizim të ri në nenin 3, pika 2, atë të “diplomatit”. Në këtë kontekst ka nevojë të shihet në tërësi projektligji aty ku bëhet referenca “Diplomati” me qëllim qartësimin e trajtimit të këtyre dy kategorive dhe unifikimin.	Ejona H.	Refuzuar	Sikurse është sqaruar në fillim të këtyre komenteve, kudo në tekstin e projektligjit referimi tek termi “diplomat” përfshin edhe diplomatët e karrierës. “Diplomat” është çdo person, i cili bëhet pjesë e Shërbimit të Jashtëm të Republikës së Shqipërisë, sipas kriterëve të caktuara në këtë ligj dhe që gëzon statusin e diplomatit për sa kohë është pjesë e tij. Diplomati e karrierës janë persona që bëjnë pjesë në shërbimin e jashtëm dhe gëzojnë statusin e diplomatit, ergo janë diplomatë.
Neni 40 “Kërkesat për pranimin në Shërbimin e Jashtëm”	Neni 40, shkronja “ç” , është një çështje që kurrësi nuk ka vend në ligj dhe mund të adresohet shumë mirë në shpalljet për rekrutim të diplomatëve. Procesi i rekrutimit duhet të nisë që me vlerësimin e nevojave dhe të përfundojë	Ejona H.	Refuzuar	Neni 40 formulon kushtet për pranimin në shërbimin e jashtëm. Nëse dy gjuhëshi duhet të

	me një Akademi Diplomatike që profilizon gjuhësisht dhe kulturalisht diplomatët tanë.			jetë kusht, atëherë vendin e ka në ligj dhe kurrësi në aktet në ligjore. Kjo është çështje e vizionit dhe e vullnetit politik që ngjiz ligjin dhe jo çështje e teknikës legislative.
	Në Nenin 40, të shtohet “personat që synojnë të bëhen pjesë e Shërbimit të Jashtëm të mos kenë nënshtetësinë e ndonjë shteti tjetër, mbasi ata do të jenë dhe nën juridiksionin e shtetit tjetër”.	KASH	Refuzuar	Vlen i njëjti koment sikurse për dygjuhëshin. Propozimi nuk qendron.
Neni 41 “Pranimi në Shërbimin e Jashtëm”	Neni 41 bie ndesh me konceptin e “diplomatit jo të karrierës” pasi si mundësi pranimi (bërje pjesë) në Shërbimin e Jashtëm kemi rekrutimin. Të ndryshojë titullin në “Pranimi si diplomat karriere në Shërbimin e Jashtëm”.	Ejona H.	Refuzuar	<i>Pranimi në shërbimin e jashtëm është pjesë e rregullave bazë të shërbimit. Përfshirja e individëve nga jashtë sistemit është pjesë e rregullave përjashtimor. Dy kategoritë janë të rregulluara qartë.</i>
	Neni 41, pika 4 ka nevojë të riformulohet. Pas përfundimit të periudhës së provës, dhe plotësimit të kërkesave sipas paragrafit 3 të këtij neni, kandidati i cili kalon me sukses testimin e organizuar nga Komisioni i Karrierës Diplomatike dhe Disiplinës bëhet pjesë e sistemit të karrierës diplomatike dhe merr gradën “Atashe”. “Nëse kandidati nuk plotëson kërkesat sipas paragrafit 3, apo nuk kalon me sukses testimin, marrëdhënia e punës në Shërbimin e Jashtëm përfundon.”	Ejona H.	Pranuar	Riformulohet sipas propozimit “Nëse kandidati nuk plotëson kërkesat sipas paragrafit 3, apo nuk kalon me sukses testimin, marrëdhënia e punës në Shërbimin e Jashtëm përfundon.”
Neni 42 “Transferimi, lëvizja paralele, ngritja në detyrë”	Pika 1- Duhet qartësuar çfare nenkupton “transferimi ne rastet e ristrukturimit te ministrise”, kalim nga nje drejtori në tjetren?	Suela J.	Sqaruar	Transferim për rastet e ristrukturimit nënkupton kalimin e diplomatit të karrierës brenda organeve të shërbimit të jashtëm
	Neni 42. Duhet të përcaktohet në nenin e përkufizimeve se çfarë është saktësisht transferimi, lëvizja paralele dhe ngritja në detyrë për diplomatët (e karrierës?) në Shërbimin e Jashtëm.	Ejona H.	Refuzuar	Terminologjia është terminologji e ligjit të nëpunësit civil. Saktësimi në

				përkufizime nuk duket i justifikuar.
Neni 43 “Verifikimi i sigorisë dhe pastërtisë së figurës”	Neni 43. Të përcaktohen ligjet ku referohen togfjalëshat “verifikim sigurie” dhe “pastërti figure”. Të parashikohet që certifikimi i sigorisë personale dhe pastërtisë së figurës është kusht <i>sine qua non</i> i vazhdimësisë së marrëdhënies në SHJ. Të parashikohet – së bashku me DAP – mundësia e transferimit të diplomatit të karrierës apo nëpunësit civil në SHJ në tjetër pozicion pune në administratën publike: 1. duke ruajtur kategorinë e pozicionit në rastet e nëpunësit civil; 2. përcaktimi i kategorisë që i përfaqësohet gradës personale në rastin e diplomatit të karrierës. Kjo sepse, jo çdo vend pune në administratën publike ka nevojë për CSP dhe pastërti figure, ndërkohë duhet të angazhohemi që këta persona, kur nuk kanë kryer vepra penale apo shkelje, të kenë siguri juridike dhe sociale në marrëdhënien e punës. Të parashikohet çfarë ndodh kur CSP pezullohet.	Ejona H.	Pranuar pjesërisht	
Neni 44 “Zhvillimi i Karrierës Diplomatike”	Neni 44 pika c dhe ç, grada e DP dhe SP duhet të jetë Ministër Fuqplotë dhe Ambasador.	KASH	Refuzuar	Kjo është çështje zgjedhjeje. Pas saj nuk ka arsyetim juridik. Propozimi nuk qendron.
Neni 45 “Punësimi jashtë Shërbimit të Jashtëm”	Në Nenin 45, pika 2, të hiqet referenca "publike" tek organizatat ndërkombëtare.	KASH	Refuzuar	Organizatë ndërkombëtare publike është një organizatë, e cila është themeluar nga shtete, qeveri ose organizata të tjera ndërkombëtare, pavarësisht nga forma juridike apo fusha e veprimit. Organizatat ndërkombëtare private janë NGO. Projektligji njihet dhe pranon si mekanizëm për ruajtjen e statusit, punësimin pranë organizatave ndërkombëtare

				publike, sepse veprimtaria në kuadër të këtyre organizatave ka natyrë diplomatike. Veprimtaria pranë NGO-ve nuk ka natyrë diplomatike. Propozimi nuk qendron.
Neni 46 “Emërimi dhe mbarimi i detyrës në misionet diplomatike dhe postet konsullore”	<i>Në Nenin 46, pika 1, lidhur me përzgjedhjen e diplomatëve të karrierës në poste diplomatike dhe konsullore jashtë vendit, të shtohet fraza “...mbas përzgjedhjes nga Komisioni i Emërimeve, i drejtuar nga SP të kandidaturave që kanë konkuruar për postin vakant, në bazë të njoftimit paraprak për vendet vakante, duke përmbushur kriteret e përcaktuara...”.</i>	KASH	Refuzuar	Dispozita përcakton kushtin për emërimin e diplomatit të karrierës në një mision diplomatik ose post konsullor. Procedura është rregulluar nga dispozita të tjera. Sugjerimi ka lidhje me formulime procedurale. Për më tepër këto formulime bien ndesh me konceptin dhe përmbajtjen e procedurës së këtij projektligji.
	<i>Ne piken 2 te këtij neni te shtohen edhe diplomatet e karrierës me gradën "këshilltar", duke mos e kufizuar tek grada "Sekretar i Pare".</i>	Parid V.	Refuzuar	Kjo është çështje zgjedhjeje. Pas saj nuk ka arsyetim juridik. Pika 2 e nenit 49 është vendosur në këtë formë për të mbajtur një standard në përfaqësimin jashtë vendit të një niveli më të lartë. Grada „këshilltar“ nuk është një grade e ulët përfaqësimi për këtë arsye vlerësohet se ky propozim nuk qendron. Pas rishikimit të kësaj pikë është

				hequr togfjalëshi „mund“ dhe pika 2 është riformuluar si më poshtë: 2. Diplomatat e karrierës të cilët mbajnë gradë diplomatike personale nga “Sekretar i Tretë” deri në “Sekretar i Parë”, emërohen në misionet diplomatike dhe postet konsullore me një gradë emërimi më të lartë se grada diplomatike personale.
	Neni 46 ka elementë të rinj pozitiv, por është e paqartë në pikën 2 të këtij projektligji se cilat janë kriteret e nevojshme për të bërë pjesë në kategorinë e diplomatëve të karrierës që “mund të emërohen me një gradë emërimi më të lartë se grada diplomatike personale” dhe atyre që nuk mund (?). Sugjeroj që në këtë pikë, fraza “mund të” të hiqet, por të jepet mundësia për diplomatët e karrierës me grada të ulëta të kenë një përfaqësim sa më dinjitoz në vendet ku akreditohen. Do të thotë kjo që diplomatët (jo të karrierës) nuk kanë kufizime në gradat e emërimit?	Ejona H.	Pranuar	Dispozita nuk ka lidhje me diplomatët që vijnë nga jashtë sistemit. Kjo pikë përfshin të gjithë diplomatët që mbajnë këto grada për të patur një përfaqësim sa më dinjitoz në vendet ku akreditohen. Propozimi për riformulim është pranuar duke e riformuluar pikën 2 të nenit 46 si më poshtë: 2. Diplomatat e karrierës të cilët mbajnë gradë diplomatike personale nga “Sekretar i Tretë” deri në “Sekretar i Parë”, emërohen në misionet diplomatike dhe postet konsullore me një gradë emërimi më të lartë se grada diplomatike personale.

Neni 50 “Dhënia e gradave diplomatike personale”	Neni 50, pika 1 (a) ka nevojë të riformulohet në përputhje me ndryshimin shumë pozitiv që i është bërë nenit 51, pika 1, sa i përket parashikimit për marrjen e gradës diplomatike personale me plotësimin e njërit prej afateve (afatit nga grada paraardhëse; ose afatit nga grada “Atashe”), duke garantuar kështu parimin e sigurisë juridike të diplomatit të karrierës. Sugjeroj të riformulohet: <i>“a) plotësimin e afatit të parashikuar në nenin 51 të këtij ligji.”</i>	Ejona H.	Refuzuar	Kjo çështje është sqaruar në komentet më sipër.
	Pika 5. Për përfitimin e gradës “Ministër Këshilltar”, përveç kushteve të pikës 1, kandidati duhet të ketë të paktën dy (katër) vjet përvojë në poste drejtuese, si dhe të ketë shërbyer të paktën një herë në misionin diplomatik apo postit konsullor. <i>Te shtohet:</i> Ne mungese te posteve drejtuese te ketë kaluar te paktën gjashtë vjet nga marrja e gradës "Këshilltar"	Parid V.	Refuzuar	Kjo është çështje zgjedhjeje, pozicioni drejtues përbën ndryshimin në përfitimin e grades duke e bërë më rigoroz procesin e përfitimi të gradave. Sugjerimi nuk shoqërohet me arsyetim. Propozimi nuk qendron.
	Në Nenin 50, pika 5, grada Ministër Këshilltar sugjerojmë të ketë dhe 1 mandat si Titullar Misioni, ndërsa pika 6 Ministër Fuqiplotë të ketë 6 vite eksperience në poste drejtuese (të përfshihet tek posti drejtues dhe ai i Përgjegjës të Sektorit, i cili duhet të përlllogaritet në raportin 2:1 me atë të Drejtorit) dhe 2 mandate si Titullar Përfaqësie diplomatike apo Misioni.	KASH	Refuzuar	Arsyetimi si më sipër, edhe kjo është çështje zgjedhjeje. Sugjerimi nuk shoqërohet me arsyetim. Propozimi nuk qendron.
	Pika 6. Për përfitimin e gradës “Ministër Fuqiplotë”, përveç kushteve të pikës 1, kandidati duhet të ketë të paktën katër (tetë) vjet përvojë në poste drejtuese, si dhe të ketë shërbyer të paktën një herë në pozicionin e kreut të misionit diplomatik apo postit konsullor. <i>Te shtohet:</i> Ne mungese te posteve drejtuese te ketë kaluar te paktën gjashtë vjet nga grada "Ministër Këshilltar".	Parid V.	Refuzuar	Edhe kjo është çështje zgjedhjeje. Sugjerimi nuk shoqërohet me arsyetim.
	Pika 9- Kjo dispozite sjell nje praktike te re e cila bie ndesh me piken 1 te ketij neni, i cili sanksionon kalimin e gradave njera pas tjetres. Kapercimi i rregullit te zbatuar per diplomatet e karrieres, per	Suela J.	Refuzuar	Kjo dispozitë formon një nga risitë e rëndësishme të projektligjit, të

	persona te ardhur jashte sistemit, e demton parimin e karrieres si dhe parimin e barazise ligjore.			cilat synojnë rritjen cilësore të përbërjes së shërbimit të jashtëm dhe forcojnë konkurrencën midis pjesëtarëve të tij. Kapacitetet profesionale që janë formuar jashtë sistemit duhet të përthithen në forma dhe me mjete që janë atraktive për ta. Përndryshe sistemi mbetet i mbyllur dhe pa mundësi rigjenerimi të shpejtë. Formulimi është në harmoni të plotë edhe me antipodin e tij, pjesëtarëve të shërbimit të jashtëm që shkëputen për të pasuruar CV-në eksperiencë pune në organizata ndërkombëtare publike u njihet vjetërsia për efekt grade. Vërejtja nuk qëndron.
	Neni 50, pikat 9 dhe 10 krahasuar me nenin 41, krijojnë një standard të dyfishtë rekrutimi për të njëjtin pozicion pune. Sipas ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, neni 5, procesi i rekrutimit duhet të bazohet në parime të caktuara që garantojnë transparencën, barazinë dhe objektivitetin. Duke u bazuar në këto parime, është e qartë që për të njëjtin pozicion pune, nuk është e duhur të përdoren standarde të ndryshme rekrutimi. Për më tepër në neni 3, pika 3/a , me ligj të posaçëm parashikohen kushte për rekrutimin. Personat e përzgjedhur sipas nenit 50, pikat 9 dhe 10, do t’i nënshtrohen periudhës së provës? Do të kryejnë ciklin e detyrueshëm të trajnimit sipas ligjit për	Marsida K.	Sqaruar, pranohet pjesërisht.	Sikurse është shpjeguar më sipër, projektligji përcakton rregullat bazë për rekrutimin, pranimin dhe karrierën në shërbimin diplomatik, por përcakton edhe rastet përjashtimore. Dy kategoritë janë të ndryshme, prandaj marrin trajtim ligjor të ndryshëm. Në

	nëpunësin civil, do të ndjekin programin e përcaktuar nga Akademia Diplomatike, do ti nënshtrohen provimit të Akademisë Diplomatike?			këto kushte nuk mund të diskutohet për standart të dyfishtë, sepse standarti i dyfishtë është koncept juridik, i cili vepron brenda të njëjtës kategori. Personat e përzgjedhur sipas nenit 50, pika 9 do ti nënshtrohen periudhës së provës dhe do të kryejnë ciklin e detyrueshëm të trajnimit sipas ligjit për nëpunësin civil, do të ndjekin programin e përcaktuar nga Akademia Diplomatike dhe do ti nënshtrohen provimit të Akademisë Diplomatike. Pika 10 hiqet.
Neni 51 “Afatet për marrjen e gradave diplomatike”	Kjo dispozite ndryshon afatet e marrjes se grades diplomatike, duke shtuar kriteret për kalimin nga një gradë në tjetrën në mënyrë shtrenguese. Në mungesë të një analize për arsyet e vështirësimit të ecurisë së karrierës diplomatike, kjo dispozite mund të cenojë parimin e sigurisë juridike dhe të pritshmërisë legjitime. Sipas këtij parimi normat juridike duhet të jenë të qarta dhe të qëndrueshme, si dhe marrëdhëniet juridike duhet të jenë deri diku të parashikueshme. Ato nuk duhet të ndryshohen në mënyrë tepër të shpeshtë duke i venë tej drejtat e fituara nga këto marrëdhënie në rrezik.	Suela J.	Refuzuar	Ndryshimi përdodhet në një hark kohor 10 vjeçar. Ky afat është optimal për rishikimin e legjislacionit. Në një hark të tillë kohor nuk cenohet as parimi i sigurisë juridike, as parimi i pritshmërisë legjitime. Reflektuar pjesërisht sugjerimi, pika 10 u hoq.
	Besoj se dihet shumë mirë nga diplomatët që janë marrë me formulimin e draft ligjit se shumë diplomatë të cilët nuk plotësonin periudhën 4 vjeçare nga garada në gradë por plotësonin periudhën totale nga përfitimi i gradës Atashe 12 vite, nuk kanë patur mundësinë të përfitojnë gradën për një	Faik D.	refuzuar	Eshtë vendosur një periudhë 3 vjeçare në poste drejtuese dhe ka mbetur sipas ligjit aktual plotësimi i dy kriterëve kohore: nga grada

	“dhe”. E cila kjo “dhe” në projekt draft është bërë “ose”, dhe është bërë shumë mirë që është ndryshuar.			ne grade dhe nga grada atashe.
	Neni 51, pika 1 është një ndryshim shumë pozitiv që tashmë rregullon situatën e përfitimit të gradave për ne diplomatët të karrierës të cilëve na është mohuar e drejta e përfitimit të gradës diplomatike personale pasardhëse, për shkak të interpretimeve të anëtarëve të Komisionit të Karrierës Diplommatike (KKD), që nuk plotësoheshin dy kushtet e përcaktuara në këtë nen për kalimin nga njëra gradë në tjetrën: 1. plotësimi i afatit për kalimin nga grada në gradën pasardhëse; 2. plotësimi i afatit nga marrja e gradës “Atashe”. Mosplotësimi i dy kushteve njëkohësisht tregon në fakt paaftësinë e organit përgjegjës për dhënien e gradave, për të zbatuar ligjin, duke mos u mbledhur brenda afateve ligjore që kanë pasjellë vonesa, duke ndikuar në plotësimin e afateve për përfitimin e gradës pasardhëse, ose duke u mos na akorduar gradat diplomatike (mua dhe disa kolegëve të tjerë) atëherë kur na ka lindur e drejta për marrjen e tyre. Në rastin tim, edhe pse kam 12 vite eksperiencë në shërbimin e jashtëm, nga të cilat 10 vite eksperiencë në struktura diplomatike, mbaj gradën personale diplomatike “Sekretar i dytë” (periudha minimale për përfitimin e të cilës është 5 vjet nga grada “Atashe”). Pra, gradën diplomatike “Sekretar i parë” duhej ta kisha përfituar para 2 vitesh (në vitin 2022), kur më lindi e drejta për përfitimin e gradës. Por grada “Atashe” nuk më është dhënë në përputhje me ligjin në fuqi (nr. 9095, datë 3.7.2003) në kohën kur më lindi e drejta për përfitimin e kësaj grade, por me ligjin nr.23/2015, që nuk ka pasur fuqi prapavepruese. Nëse i referohemi të gjitha dispozitave të ligjit nr.23/2015, vëmë re se ato janë kryesisht ligje materiale. Lidhur me zbatimin në kohë të ligjit material i referohemi vendimit Unifikues nr.3/2013, nëpërmjet së cilit Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë na kanë arsyetuar se “...Zbatimi i ligjit material lidhet me momentin kur ka ndodhur	Ejona H.	refuzuar	Gradat nuk akordohen automatikisht për shkak të afatit. Afati është një nga kriteret/kushtet për përfitimin e gradës. Për këtë arsye, ky formulim është i papajtueshëm.

	<i>shkelja, kufizimi apo lindja e së drejtës. Për këtë arsye, si rregull, në rastet kur në fillim apo vijim të procesit gjyqësor ndryshon ligji material, do të vazhdojë të zbatohet ligji i mëparshëm. Përjashtim bëjnë rastet kur vetë ligji i ri ka parashikuar fuqinë prapavepruese të tij... ”.</i> Njëkohësisht, Gjykata Kushtetuese është shprehur se: “...ligjvënësi duhet të mbajë parasysh se një situatë të rregulluar më parë, parimisht mund ta ndryshojë vetëm nëse kjo sjell pasoja pozitive për subjektet përfituese dhe jo kur ndryshimi i akteve e përkeqëson situatën, pra i heq subjekteve fituese një të drejtë të fituar më parë.....”. (Vendimi nr.2/2013 dhe vendimi nr.9/2007) Mosrespektimi i ligjit material përbën shkelje të parimit të sigurisë juridike të sanksionuar nga Gjykata Kushtetuese. Për të garantuar parimin e sigurisë juridike, por edhe atë të vazhdimësisë së karrierës diplomatike, sugjeroj të shtohet një paragraf i ri (nr. 2) me këtë përmbajtje: <i>“2. Përllogaritja e afatit për fitimin e gradës diplomatike pasardhëse të njihet nga momenti që lind e drejta për përfitimin e gradës diplomatike personale.”</i> Në këtë frymë, dhe togfjalëshi “periudha minimale” të zëvendësohet me “afati” (për të qenë koherent edhe me nenin 50, pika 1). Kjo, për të njohur vitet për marrjen e gradave diplomatike edhe, në rast se KKD nuk mblidhet sërish me argumentin se pritët hyrja në fuqi e ligjit të ri që propozohet. Por edhe që mos të humbasin muajt sepse KKDD mblidhet vetëm në muajt mars dhe shtator (neni 22, pika 4 (a)). Për të rregulluar edhe këtë situatë, kam bërë një sugjerim më lartë, për nenin që trajton këtë çështje. Theksoj që një parashikim i tillë NUK është “bonus-i” që përflitet në MEPJ, dhe as njohje e eksperiencës së punës për efekt të përllogaritjes së afatit kohor të nevojshëm për përfitimin e gradave diplomatike personale, që parashikohet në nenin 51, pika 10, të këtij projektligji,	Ejona H. Silvana L.		
--	--	--------------------------------	--	--

	që në fakt janë parashikime që bien ndesh me parimin e marrjes së gradave diplomatike njëra pas tjetrës dhe cenojnë parimin e sigurisë juridike të diplomatit të karrierës. Ky parashikim garanton njohjen e periudhës për marrjen e gradës pasardhëse, pa anashkaluar gradën paraardhëse. Pra, për të rregulluar situatën e krijuar nga mbledhja e KKD vetëm 1 herë në vit për të dhënë gradat, edhe pse ligji parashikon mbledhjen e tij 2 herë, duke cenuar jo vetëm plotësimin e afatit për marrjen e gradës paraardhëse por edhe financiarisht diplomatin. Nëse 5 anëtarët e komisionit e kanë të pamundur mbledhjen 2 herë në vit, ose nëse nuk pranohet propozimi për sugjerimin e bërë për nenin 22, pika 4 (a), <i>mund të shihet mundësia që gradat deri në sekretar i parë (që nuk konsiderohen grada të larta) të jepen automatikisht me plotësimin e afatit për përfitimin e tyre, pa qenë nevoja e bërjes së kërkesës, duke qenë se struktura e burimeve njerëzore disponon të dhënat e nevojshme.</i>			
	Afatet për marrjen e gradave diplomatike (Të zëvendësohet lidhëse ose me dhe pasi bie ndesh me piken 1 te Nenit 50 dhe lë vend për abuzime) 1. Periudha minimale për kalimin e diplomatit nga një gradë në një tjetër më të lartë është: a. nga “Atashe” në “Sekretar i Tretë” -2 vjet; b. nga “Sekretar i Tretë” në “Sekretar i Dytë”-3 vjet dhe (ose) 5 vjet nga marrja e gradës “Atashe”; c. nga “Sekretar i dytë” në “Sekretar i Parë” -3 vjet dhe (ose) 8 vjet nga marrja e gradës “Atashe”; ç) nga “Sekretar i parë” në “Këshilltar” - 4 vjet dhe (ose) 12 vjet nga marrja e gradës “Atashe”; d) nga “Këshilltar” në “Ministër këshilltar” - 4 vjet dhe (ose) 16 vjet nga marrja e gradës “Atashe”; dh) nga “Ministër Këshilltar” në “Ministër Fuqiplotë”- 4 vjet dhe (ose) 20 vjet nga marrja e gradës “Atashe”; e) nga “Ministër fuqiplotë” në “Ambasador”- 4 vjet dhe (ose) 24 vjet nga marrja e gradës “Atashe”	Parid V.	Pranuar	

	Në Nenin 51, gërma dh, ngritja nga Ministër Këshilltar në Ministër Fuqiptotë të bëhet 6 vite dhe gërma e, nga Ministër Fuqiptotë në Ambasador të bëhet 8 vite dhe gjithsej karrierë 30 vite.	KASH	Pranuar pjesërisht	Grada nga Ministër Këshilltar në Ministër Fuqiptotë është bërë 6 vjet. Kjo është çështje zgjedhjeje. Pas saj nuk ka arsyetim juridik.
Neni 52 “Barasvlera e gradave”	Në Nenin 52, pika b, Konsulli të barazohet me Këshilltar dhe 2 pozicionet e tjera të zbresin më poshtë.	KASH	Refuzuar	Edhe kjo është çështje zgjedhjeje. Pas saj nuk ka arsyetim juridik.
Neni 53 “Të drejtat”	Në Nenin 53, pika d, të shtohet dhe “institucionet homologe ndërkombëtare”.	KASH	Pranuar pjesërisht	“Institucionet homologe ndërkombëtare” ndoshta nuk është terminologji e përshtatshme. Gjithsesi, fjalia mund të riformulohet: “d) të përfitojë nga kualifikimet dhe trajnimet e ofruara nga Ministria, nga Akademia Diplomatike ose institucioneve të tjera në bashkëpunim ose me pëlqimin e Ministrisë.
Neni 55, “Trajtimi financiar i personelit të Shërbimit të Jashtëm”	Pika 1, thuhet: “Paga e diplomatëve të karrierës, të cilët punojnë në Ministri, caktohet në bazë të funksionit që ata kryejnë dhe gradës diplomatike personale”. Fryma e projekt ligjit për shërbimin e jashtëm mbështet në sistemin e karrierës diplomatike, gradave diplomatike personale dhe natyrisht në bartësit e sajë, Diplomatët e karrierës. Në këtë kontekst po t’i referohesh projekt ligjit të publikuar për konsultim do të vëmë re se: • Neni 3, Përkufizime, kemi termat, “Diplomat karriere”, “Gradë diplomatike personale”. • Neni 4, Parimet e shërbimit të jashtëm, kemi termin, “vazhdimësisë së karrierës”. • Neni 11, Bashkërendimi institucional, pika 2, kemi termin,	Faik D.	Pranuar	

	“emërohen nga diplomatët e karrierës”. • Neni 2, Komisioni i Karrierës Diplomatike dhe disiplinës, pika 3, kemi termin, “me gradën diplomatike personale më të lartë”, “tre diplomatë karriere me gradën diplomatike më të lartë”. • Neni 33, Përzgjedhja e kreut të misionit diplomatik, pika 1, kemi termin, “përzgjidhet ndërmjet diplomatëve të karrierës me gradë më të lartë”. • Neni 36, Kreu i postit konsullor, pika 2, kemi termin, “nga rradhët e diplomatëve të karrierës”. Pra, duke parë ligjin në tërësi dhe në detaje ai frymëzohet nga sistemi i karrierës diplomatike, që nënkuptojnë në thelb përfitimin e gradave diplomatike në funksion të kohës në shërbimin e jashtëm, vlerësimit të marrë në këtë shërbim ndër vite të karrierës si diplomat. Në këto kushte do të ishte jo e drejtë që paga e diplomatit të përcaktohet në radhë të parë në bazë të funksionit që ata kryejnë, dhe më pas në radhë të dytë përcaktohet, dhe gradës diplomatike. Kjo renditje bie ndesh me frymen e ligjit dhe në mënyrë indirekte mund të cënojë pagën e diplomatëve. Si shembull mund të sjellim në vëmendje nenin 48 në ligjin aktual për shërbimin e jashtëm, ku thuhet, p.sh. pika ç, e nenit 48 në ligjin 23/2015, ç. Nga sekretar i parë në këshilltar – 4 vjet dhe 12 vjet nga marrja e gradës “Atashe”. Besoj se dihet shumë mirë nga diplomatët që janë marrë me formulimin e draft ligjit se shumë diplomatë të cilët nuk plotësonin periudhën 4 vjeçare nga garada në gradë por plotësonin periudhën totale nga përfitimi i gradës Atashe 12 vite, nuk kanë patur mundësinë të përfitojnë gradën për një “dhe”. E cila kjo “dhe” në projekt draft është bërë “ose”, dhe është bërë shumë mirë që është ndryshuar. Sipas formulimit të bërë në projekt ligj do të kemi si rrjedhojë që diplomatët e karrierës të cilët posedojnë një gradë diplomatike personale, të paguhet sipas			
--	--	--	--	--

	pozicionit (sistemit të nëpunësve me b1, b2 etj) që kanë në MEPJ dhe jo sipas gradës diplomatike personale. Kjo bie ndesh me frymën e ligjit dhe me një sërë nenesh dhe dispozitash që përmban ky projekt ligj. Në këtë frymë do të sugjeroja komisionit që, kur të marrë në shqyrtim sugjerimet mbi draftin, pika 1, e nenit 55 të projekt draftit të qëndrojë ashtu si edhe është edhe neni 53 në ligjin aktual 23/2015. “Paga e diplomatit të karrierës, i cili punon në Ministrinë (për Evropën dhe) e Punëve të Jashtme, caktohet në bazë të gradës diplomatike personale dhe funksionit që ai kryen”.			
Neni 56 “Trajtimi i familjeve të personelit të misionit diplomatik dhe postit konsullor”	Në Nenin 56, pika 7, të shtohet “kur regjistrohet në listë pritje, duhet paguar me nivelin e pagës që merrte përpara largimit nga puna.” Së fundi, na lejoni, Z. Ministër, të shprehim gjithë gatishmërinë tonë për t’u angazhuar në konsultime me grupin përkatës të punës për hartimin e Projekt-ligjit, në funksion të hartimit të një Ligji të denjë për Shërbimin tonë të jashtëm.	KASH	refuzuar	Rregullimi i pikës 7 derivon nga statusi i nëpunësit civil dhe përcaktohet në legjislacionin e fushës. Këtu është përsëritur vetëm për nevojat e këtij ligji.
Dispozita kalimtare	Në vijim të argumenteve të sipërcituara, mendoj që duhet të vlerësohet mundësia për përfshirjen e një dispozite kalimtare që të rregullojë marrëdhëniet juridike ekzistuese deri në hyrjen në fuqi të ligjit të ri, me qëllim që të: 1. garantohej barazia e trajtimit të diplomatëve të karrierës për gradat e emërimit, kur ekzistojnë emërimet në misione diplomatike dhe poste konsullore me gradën diplomatike personale; me grada më të larta se personalja; dhe tani me nenin 46, të këtij projektligji, “mund të emërohen” me një gradë emërimi më të lartë se grada diplomatike personale; 2. garantohej siguria juridike të diplomatëve të karrierës që plotësojnë afatin për përfitimin e gradave të larta, që projektligji në nenin 51 i ndryshon duke zgjatur afatin dhe vështirësuar marrjen e gradës pasardhëse, e për rrjedhojë vazhdimësinë e karrierës diplomatike.	Ejona H.	Refuzuar	Rregullimi i ri i pagave duhet të hyjë në fuqi, sapo ligji i ri të bëhet i zbatueshëm. Dispozita kalimtare është e pajustifikueshme. Arsyeimi rreth afatit për kalimin nga një gradë në tjetrën është bërë në disa pika më sipër. Afati nuk është kriteri/kushti i vetëm për përfitimin e gradës dhe nuk duhet të trajtohet si i tillë. Numërimi i vjetërsisë në një gradë nuk fillon nga data e hyrjes në fuqi të ligjit, por nga data kur është përfituar grada.

